



# Kolegji AAB

Rr. "Elez Berisha", nr. 56, Zona Industriale  
Prishtinë-Fushë Kosovë, 10000 Prishtinë,  
Republika e Kosovës,  
Tel: +383 38 600 005; +383 45 284 797  
Mail: [info@aab-edu.net](mailto:info@aab-edu.net);  
[www.aab-edu.net](http://www.aab-edu.net)

---


Ref. nr. 216 . Prishtinë, 29/04/2024


---

## RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS

--

--

Aprovuar nga:	Këshilli Drejtues Kryetari i Këshillit Drejtues. 
---------------	---



Data e Miratimit	29.04.2024
------------------	------------

Ref. Nr.	216/2024
----------	----------

Në zbatim të Statutit të Kolegjit AAB (në tekstin ë mëtejshëm AAB) dhe mbështetur në të, Këshilli Drejtues miraton këtë rregullore.

## **R R E G U L L O R E**

### **ORGANIZIMIN DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS**

#### **I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

##### **Neni 1**

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Kolegjin AAB.

##### **Neni 2**

1. Kjo Rregullore zbatohet nga të gjitha strukturat organizative brenda Kolegjit AAB
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Kolegjit AAB përcaktohen me Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Statutin e Kolegjit AAB, si dhe legjislacionit përkatës në fuqi.
3. Sipas kësaj Rregulloreje, organizimi i punës mundëson aplikimin e legjislacionit në fuqi, akteve nënligjore dhe akteve tjera të brendshme të Kolegjit AAB, si dhe aktiviteteteve të tjera që janë në kompetencë të Kolegjit AAB.

#### **II. STRUKTURA ORGANIZATIVE E KOLEGJIT AAB**

##### **Neni 3**

1. Struktura e organeve qeverisëse të Kolegjit AAB është si vijon:
  - 1.1. Këshilli Drejtues;
  - 1.2. Senati;
  - 1.3. Rektori.
2. Rregullimi dhe funksionimi i Këshillit Drejtues dhe Senatit parashihet me Statut dhe nuk trajtohet me këtë rregullore.

#### **III. REKTORI**

##### **Neni 4**

1. Zyra e Rektorit përbëhet nga:

- 1.1. Rektori;
- 1.2. Prorektorët;
- 1.3. Sekretari i përgjithshëm;
- 1.4. Drejtori i degës.

2. Personeli mbështetës i Zyrës së Rektorit përbëhet nga:

- 2.1. Këshilltari për media dhe marrëdhënie me publikun;
- 2.2. Këshilltari për analiza dhe inovacion;
- 2.3. Këshilltari për çështje juridike;
- 2.4. Asistenti/ja administrativ;
- 2.5. Shoferi.

## **Neni 5**

### **Rektori**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Rektorit janë:

- 1.1. të veprojë në emër të AAB-së dhe ta përfaqësojë atë para publikut dhe më gjerë;
- 1.2. të planifikojë, organizoj, udhëheqë dhe të mbikëqyre proceset dhe zhvillimet e institucionit;
- 1.3. t'i prezantojë Këshillit Drejtues propozimet, rekomandimet dhe opinionet e Senatit;
- 1.4. të kryesojë Senatin;
- 1.5. të vendosë një sistem të brendshëm për sigurimin e cilësisë;
- 1.6. të drejtojë dhe zhvillojë gjithë punën mësimore – edukuese e shkencore – artistike;
- 1.7. të sigurojë shfrytëzimin efikas, ekonomik dhe të dobishëm të mjeteve të AAB-së;
- 1.8. të sigurojë përdorimin efikas të burimeve, kapaciteteve të AAB-së dhe ruajtjen e pronës;
- 1.9. të vendosë për shpalljen e konkursit për pranimin e studentëve;
- 1.10. i propozon Këshillit Drejtues strategjinë për bursa;
- 1.11. të zbatojë vendimet e Këshillit Drejtues;
- 1.12. t'i propozojë Këshillit Drejtues Prorektorët;
- 1.13. të emërojë personelin udhëheqës në pozita të caktuara;
- 1.14. të shpallë fituesit e konkurseve të pranimi;
- 1.15. të ndajë çmime dhe mirënjohje;
- 1.16. inicon nxjerrjen e rregulloreve të reja, plotësimin dhe ndryshimin e tyre, dhe ndryshimin e statutit;
- 1.17. të mbajë takime të rregullta javore me stafin menaxherial dhe njofton Kryetarin e Këshillit Drejtues për vendimet e marra në këto takime;
- 1.18. të nënshkruaj diplomat e të diplomuarve të të gjitha niveleve;

- 1.19. formon komisione ad hoc për çështje të caktuara;
- 1.20. bën vlerësimin e rregullt të stafit nën mbikëqyrje të tij dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimit për kryerje të detyrave të tyre
- 1.21. të kryejë të gjitha detyrat e tjera siç janë përcaktuar me këtë Statut dhe rregulloret e tjera në fuqi.

## **Neni 6**

### **Prorektori për çështje mësimore dhe akademike**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Prorektorit për çështje mësimore dhe akademike janë:
  - 1.1. në bashkëpunim me Rektorin dhe dekanët dhe menaxherët e sektorëve harton Planin vjetor të punës;
  - 1.2. zbaton politikat për sigurimin e cilësisë së shërbimeve akademike;
  - 1.3. mbikëqyrë punën e dekanëve dhe drejtorëve të degëve dhe ofron rekomandime për zgjidhjen e çështjeve të ndryshme;
  - 1.4. vlerëson, zhvillon dhe zbaton programet ekzistuese akademike dhe harton raporte e rekomandime për përmirësimin e cilësisë së programeve mësimore dhe të mësimdhënies;
  - 1.5. në bashkëpunim me prorektorët, dekanët, drejtorët e degëve shqyrton ndërmerr masa për zbatimin e politikave dhe praktikave të reja në procesin mësimor – akademik;
  - 1.6. ne koordinim me rektorin, prorektorët dhe dekanët harton dhe aprovon politikat e implementimit të teknologjisë në shërbim të proceseve akademike;
  - 1.7. identifikon nevojat dhe prioritetet për zhvillimin e programeve te reja studimore;
  - 1.8. zhvillon dhe zbaton procesin e vlerësimit të programeve dhe përkujdesët për përmbushjen e standardeve profesionale e akademike;
  - 1.9. udhëheqë Komisionin për Studime;
  - 1.10. në bashkëpunim me dekanët, drejtorët e degëve dhe me drejtorin e bibliotekës bënë rishikimin e nevojave për literaturë dhe harmonizimin e saj me programet e studimit;
  - 1.11. miraton raportet për rezultatet përfundimtare të provimit;
  - 1.12. miraton planet dhe raportet periodike të dekanëve;
  - 1.13. merr pjesë në mbledhjet e Këshillit Drejtues;
  - 1.14. shqyrton kërkesat ditore të dekanëve, stafit akademik, menaxherëve dhe studentëve që lidhen me procesin mësimor;
  - 1.15. inicon dhe merr pjesë në hartimin e rregulloreve qe kane te bëjnë me çështjet akademike;
  - 1.16. kujdeset për zbatim të akteve juridike të institucionit në fushën e çështjeve mësimore;
  - 1.17. bën vlerësimin e rregullt të stafit nën mbikëqyrje të tij dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimit për kryerje të detyrave të tyre;
  - 1.18. kryen edhe detyra të tjera sipas kërkesës së rektorit;

- 1.19. e publikon planin e punës në eMenaxher dhe monitoron publikimin e planeve përkatëse të vartësve;
  - 1.20. prorektori për çështje mësimore dhe akademike për punën e tij i përgjigjet Rektorit.
2. Prorektori për çështje mësimore dhe akademike për punën e tij i përgjigjet Rektorit.

## **Neni 7**

### **Prorektori për shkencë**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e prorektorit për shkencë janë:
  - 1.1. udhëheq dhe koordinon punën kërkimore shkencore dhe projektet hulumtuese;
  - 1.2. këshillon rektorin në fushëveprimin e sektorit të shkencës;
  - 1.3. në bashkëpunim me fakultetet, harton projekte shkencore dhe aplikon për grante hulumtuese shkencore;
  - 1.4. harton dhe mbikëqyrë metodologjinë për respektimin e standardeve dhe procedurave të temave të masterit sipas Rregullores për studime master;
  - 1.5. kërkon statistika dhe informacione të tjera që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e temave të masterit;
  - 1.6. krijon dhe përdorë bazën e të dhënave të studimeve master;
  - 1.7. zhvillon kapacitetet e Komisioneve të Studimeve Master;
  - 1.8. në bashkëpunim me Zyrën për marrëdhënie me publikun, koordinon publikimin e të dhënave nga temat e masterit;
  - 1.9. koordinon konferencat shkencore në bashkëpunim me dekanatet;
  - 1.10. koordinon dhe mbikëqyrë regjistrimin në bazën e të dhënave të projekteve shkencore të realizuara nga fakultetet;
  - 1.11. koordinon shqyrtimin e kërkesave të stafit për pjesëmarrje në konferenca shkencore;
  - 1.12. drejton Revistën shkencore, sipas detyrave që parashikohen për një kryeredaktor nga Council of Science Editors;
  - 1.13. mbikëqyr/redakton revistën për numrat specialë të konferencave (sipas parimit dhe detyrave të kryeredaktorit);
  - 1.14. drejton shtëpinë botuese sipas parimeve e detyrave të parapara nga Council of Science Editors;
  - 1.15. harton planin dhe strategjinë zhvillimore për sektorin e shkencës, duke paraparë fushat e veprimit, mekanizmat dhe strukturat bartëse të aktiviteteve të caktuara;
  - 1.16. mbledh dhe shpërndan informacione për projekte dhe iniciativa të ndryshme ndërkombëtare për sektorin e shkencës;
  - 1.17. në bashkëpunim me zyrën për bashkëpunim ndërkombëtar, inicon marrëveshje bashkëpunimi me qëllim të realizimit të konferencave ndërkombëtare;

- 1.18. përgatit materialet nga sektori i shkencës dhe e prezanton këtë sektor në procesin e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm;
  - 1.19. në bashkëpunim me Zyrën për marrëdhënie me publikun, drejton publikimet e ndryshme që ndërliken me veprimtarinë e sektorit të shkencës;
  - 1.20. merr pjesë në mbledhjet e Senatit dhe të kolegjiut të dekanëve;
  - 1.21. koordinon lekturimin e materialeve të Zyrës së kërkimit shkencor, si: revista Thesis, materialet e konferencave, lekturimi i temave master, publikime;
  - 1.22. bën vlerësimin e rregullt të stafit nën mbikëqyrje të tij dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimit për kryerje të detyrave të tyre;
  - 1.23. kryen edhe detyra të tjera sipas kërkesës së Rektorit.
2. Prorektori për kërkim shkencor për punën e tij i përgjigjet Rektorit.

## **Neni 8**

### **Prorektori për financa**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e prorektorit për financa janë:
  - 1.1. koordinon hartimin e planit buxhetor të institucionit;
  - 1.2. shqyrton dhe aprovon kërkesat financiare të sektorëve;
  - 1.3. zhvillon objektiva afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata financiare në pajtim me procedurat administrative;
  - 1.4. mbikëqyrë punën e Zyrës së financave;
  - 1.5. inicion hartimin e rregulloreve financiare dhe siguron zbatimin e tyre;
  - 1.6. mbikëqyrë të hyrat dhe shpenzimet;
  - 1.7. bashkëpunon me banka dhe institucione tjera financiare;
  - 1.8. propozon tarifrat për studime dhe shërbime administrative;
  - 1.9. aprovon propozimet për skemën e bursave;
  - 1.10. koordinon bashkëpunimin e sektorit të financave me sektorët tjerë;
  - 1.11. shqyrton dhe aprovon marrëveshjet/kontratat të cilat kanë implikime financiare;
  - 1.12. mbikëqyrë zbatimin e investimeve kapitale;
  - 1.13. bën vlerësimin e rregullt të stafit nën mbikëqyrje të tij dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimit për kryerje të detyrave të tyre
  - 1.14. publikon planin e punës në e-Menaxher dhe monitoron publikimin e planeve përkatëse të vartësve;
  - 1.15. kryen edhe detyra të tjera sipas kërkesës së Rektorit.
2. Prorektori për financa për punën e tij i përgjigjet Rektorit.

## Neni 9

### Prorektori për planifikim dhe zhvillim

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Prorektorit për planifikim dhe zhvillim janë:
  - 1.1. planifikon, harton, menaxhon dhe zbaton projektet në fushën e investimeve në koordinim me sektorët tjerë;
  - 1.2. bashkëpunon me prorektorët e tjerë, në përkrahje të aktiviteteve për realizimin e procesit mësimor dhe kërkimeve shkencore;
  - 1.3. bënë hulumtimin e tregut dhe zhvillimet e teknologjisë për nevoja të programeve studimore;
  - 1.4. propozon strategjinë për marrëdhënie me publikun dhe mbikëqyrë zbatimin e saj;
  - 1.5. planifikon dhe organizon aktivitetet e marrëdhënieve me publikun dhe komunikimin me media duke bashkëpunuar me sektorët përkatës;
  - 1.6. propozon projekte në kuadër të nismave të përgjegjësive sociale;
  - 1.7. kujdeset për implementimin e teknologjive të reja;
  - 1.8. organizon, udhëheq dhe koordinon punën e shërbimeve të zyrave përkatëse;
  - 1.9. përkujdeset për kushtet organizative, infrastrukurore dhe teknologjike të zhvillimit të procesit mësimor;
  - 1.10. mbikëqyrë punën e Zyrës për shërbime mbështetëse;
  - 1.11. mbikëqyrë punën e Zyrës për marketing;
  - 1.12. komunikon me media dhe përcjell hapësirën mediale që i kushtohet institucionit, duke bashkëpunuar ngushtë me sektorin e marketingut;
  - 1.13. inicon hartimin e procedurave protokolare të institucionit dhe përkujdeset për zbatimin e tyre;
  - 1.14. koordinon hartimin e materialeve promovuese dhe përkujdeset për përmbajtjen dhe pamjen e ueb faqes së institucionit;
  - 1.15. përkujdeset për format e rritjes së prezencës digjitale të institucionit në ranglistat ndërkombëtare;
  - 1.16. në bashkëpunim me prorektorët tjerë, propozon aplikimin e veglave përkatëse dhe formave për e-Learning, distance learning dhe blended learning, në programet studimore;
  - 1.17. përkujdeset dhe propozon për gjetjen e formave të bashkëpunimit që janë në funksion të zbatimit të ideve inovative të personelit e të studentëve në tregun e punës, duke bashkëpunuar me sektorët përkatës;
  - 1.18. përkrahë dhe promovon idetë inovative të studentëve;
  - 1.19. bën vlerësimin e rregullt të stafit nën mbikëqyrje të tij dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimit për kryerje të detyrave të tyre;
  - 1.20. publikon planin e punës në e-menaxher dhe monitoron publikimin e planeve përkatëse të vartësve;
  - 1.21. kryen edhe detyra të tjera sipas kërkesës së Rektorit.
2. Prorektori për planifikim dhe zhvillim për punën e tij i përgjigjet Rektorit.



## Neni 10

### Prorektori për bashkëpunim të jashtëm

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e prorektorit për bashkëpunim të jashtëm janë:
  - 1.1. koordinon dhe menaxhon të gjitha çështjet që lidhen me bashkëpunimin e jashtëm të institucionit në pajtim me Planin Strategjik të institucionit;
  - 1.2. harton planin e punës të zyrës për marrëdhënie me jashtë, duke paraparë fushat e veprimit, mekanizmat dhe strukturat bartëse të aktiviteteve të caktuara;
  - 1.3. koordinohet me prorektorët e fushave përkatëse lidhur me çështje dhe aktivitete që kanë të bëjnë me marrëdhëniet me jashtë;
  - 1.4. hulumton mundësitë e marrëveshjeve dhe formave të tjera të bashkëpunimit me institucione të arsimit të lartë dhe institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit dhe kujdeset për implementimin e tyre;
  - 1.5. hulumton, identifikon dhe shqyrton mundësitë e organizimit dhe pjesëmarrjes së stafit akademik, stafit administrativ dhe studentëve në aktivitete ndërkombëtare me qëllim të avancimit të procesit të mësimdhënies dhe punës hulumtuese – shkencore;
  - 1.6. negocion, përgatit dhe nënshkruan marrëveshjeve vendore dhe ndërkombëtare të bashkëpunimit sipas autorizimeve të Rektorit;
  - 1.7. koordinon nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me jashtë për sektorët e tjerë të institucionit;
  - 1.8. është pjesë e secilit delegacion të institucionit për nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit;
  - 1.9. në bashkëpunim me dekanatet, përkujdeset për mobilitetet ndërkombëtar duke promovuar, siguruar dhe mbështetur të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me mobilitet të studentëve dhe stafit akademik;
  - 1.10. shërben si koordinator për informim dhe përfshirje të universitetit në projekte dhe organizata ndërkombëtare;
  - 1.11. siguron bazën e informacioneve relevante për institucionin, qoftë në formë elektronike apo edhe forma të publikimeve të ndryshme, që do i shërbenin studentëve nga institucionet partnere për t'u njohur me mundësinë e studimeve në institucion;
  - 1.12. angazhohet për sigurimin e resurseve njerëzore nga jashtë duke siguruar bashkëpunëtorë të jashtëm, profesorë vizitorë dhe vendos kontakte me partnerë të jashtëm të cilët sjellin përvojat e tyre në procesin mësimor dhe në organizimin strukturor, administrativ e menaxhues, duke angazhuar ekspertë të jashtëm;
  - 1.13. angazhohet për anëtarësimin e institucionit në nisma universitare rajonale dhe evropiane;
  - 1.14. ndërmerr veprime për të siguruar njohjen e studimeve dhe diplomave të institucionit në universitete jashtë vendit;

- 1.15. është përgjegjës për organizimin e Shkollës Verore të institucionit në bashkëpunim me Prorektorët;
  - 1.16. bën vlerësimin e rregullt të stafit nën mbikëqyrje të tij dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimit për kryerje të detyrave të tyre;
  - 1.17. publikon planin e punës në e-manager;
  - 1.18. përkujdeset për bazën e të dhënave të institucionit për bashkëpunimet e jashtme;
2. Prorektori për bashkëpunim të jashtëm për punën e tij i përgjigjet Rektorit.

## **Neni 11**

### **Sekretari i përgjithshëm**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sekretarit të përgjithshëm janë:
  - 1.1. është përgjegjës për punën juridike dhe administrative të institucionit;
  - 1.2. përfaqëson institucionin në konteste dhe çështje tjera juridike dhe kontribuon për zgjidhjen e tyre;
  - 1.3. me autorizimin e Rektorit, përgatit dhe nënshkruan kontratat e punës me personelin administrativ dhe akademik;
  - 1.4. siguron zbatimin adekuat dhe respektimin e ligjeve të aplikueshme, rregullave, politikave, udhëzimeve dhe doracakëve të nxjerra nga institucioni;
  - 1.5. merr pjesë në hartimin e kontratave me palët e treta;
  - 1.6. është përgjegjës për inicimin dhe përgatitjen e akteve juridike të institucionit dhe bënë interpretimin e tyre sipas kërkesave të sektorëve;
  - 1.7. është përgjegjës për mbajtjen e evidencës së rregullt për kandidatët që paraqiten për punësim, personelin me kontratë, dokumentacionin e pronës, etj.
  - 1.8. në bashkëpunim me Drejtorët përkatës, angazhohet në harmonizimin e procedurave që kanë për qëllim rritjen e efikasitetit në sektorë;
  - 1.9. është përgjegjës për sigurimin e mbarëvajtjes së procedurave të rekrutimit të punëtorëve, përgatitë konkurset, akt emërimet, kontratat për marrëdhënien e punës, dhe bën mirëmbajtjen e dosjeve të personelit;
  - 1.10. përkujdeset për kompletimin e dosjeve të personelit akademik dhe dokumentacionin tjetër në harmoni me kërkesat ligjore;
  - 1.11. pranon dhe referon dërgesat e pranuar në emër të institucionit;
  - 1.12. përgjigjet në të gjitha kërkesat e tjera ligjore;
  - 1.13. përgatit dhe lëshon vërtetime dhe dëshmi për studentët dhe personelin sipas kërkesës;
  - 1.14. bashkëpunon me prorektorët rreth çështjeve të administratës dhe studentëve;
  - 1.15. kujdeset për zbatimin e procedurave të konkursit për avancim akademik të personelit;
  - 1.16. përpilon vendimet dhe aktet tjera juridike që i lëshon Rektori;

- 1.17. përgatit mbledhjet e Senatit;
- 1.18. udhëheqë punën e zyrës së personelit;
- 1.19. udhëheqë arkivin dhe është përgjegjës për zbatimin e ligjshmërisë lidhur me arkivimin e lëndëve;
- 1.20. në bashkëpunim me zyrën për teknologji, kujdeset për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e arkivës elektronike;
- 1.21. siguron zbatimin e legjislacionit lidhur me menaxhimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore;
- 1.22. mban dosjet personale të pushimeve të personelit dhe në bashkëpunim me mbikëqyrësit cakton periudhën e pushimit;
- 1.23. mbështet punën e komisioneve të Senatit;
- 1.24. bën vlerësimin e rregullt të stafit nën mbikëqyrje të tij dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimit për kryerje të detyrave të tyre;
- 1.25. e publikon planin e punës në eMenaxher dhe monitoron publikimin e planeve përkatëse të vartësve;
- 1.26. përmbushë edhe obligime të tjera të kërkuara nga Rektori.

2. Sekretari i përgjithshëm për punën e tij i përgjigjet Rektorit.

## **Neni 12**

### **Drejtori i degës**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të degës janë:

- 1.1. kujdeset për mbarëvajtjen e punëve akademike, administrative dhe teknike në degë;
- 1.2. përfaqëson degën në të gjitha instancat me palët e treta sipas autorizimit të Rektorit;
- 1.3. ndërmer masat e nevojshme për zbatimin e vendimeve dhe detyrave të caktuara nga Rektori;
- 1.4. i propozon Rektorit, organizimin e tryezave, debateve, ligjëratave më ligjërues të jashtëm dhe aktiviteteve tjera;
- 1.5. kujdeset për organizimin e aktiviteteve jashtë-kurikulare të studentëve;
- 1.6. bashkëpunon me Dekanatet në organizimin e punës hulumtuese në degë;
- 1.7. merr pjesë në mbledhjet e thirrura nga Rektori;
- 1.8. jep këshilla dhe rekomandime për rektorin dhe dekanin për angazhimin e stafit akademik në degë;
- 1.9. mbikëqyrë procesin mësimor në përputhje me orarin mësimor;
- 1.10. pranon dhe shqyrton si instancë e parë kërkesat dhe ankesat e studentëve dhe personelit;
- 1.11. përgatitë raporte periodike dhe vjetore për rektorin;
- 1.12. në bashkëpunim me drejtorët përkatës mbikëqyrë punën e shërbimit të studentëve dhe shërbimeve tjera mbështetëse në degë dhe kujdeset për mbarëvajtjen e tyre;
- 1.13. bashkëpunon me zyrën e marketingut në promovimin e degës;

- 1.14. propozon hapjen e drejtimeve të reja në degë;
- 1.15. në bashkëpunim me drejtorin e bibliotekës, mbikëqyrë punën e bibliotekës dhe librarisë në degë;
- 1.16. propozon ide që kanë për qëllim zhvillimin e degës;
- 1.17. kujdeset për ruajtjen dhe ngritjen e imazhit të degës;
- 1.18. koordinon praktikat e studentëve të degës;
- 1.19. bën vlerësimin e rregullt të stafit nën mbikëqyrje të tij dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimit për kryerje të detyrave të tyre;
- 1.20. publikon detyrat e planit të punës në e-manager;
- 1.21. kryen punë dhe funksione tjera që i cakton rektori.

2. Drejtori i degës për punët e tij i përgjigjet rektorit.

#### **IV. ZYRAT**

##### **Neni 13**

##### **Zyra për sigurim të cilësisë**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrës për sigurim të cilësisë janë:
  - 1.1. është përgjegjëse për zbatimin e gjitha proceseve të lidhura me sigurimin e jashtëm dhe të brendshëm të cilësisë;
  - 1.2. zbaton Strategjinë e Sigurimit të Cilësisë së institucionit;
  - 1.3. zbaton politika dhe procese të sigurimit të cilësisë në përputhje me Strategjinë e Sigurimit të Cilësisë;
  - 1.4. kryen vlerësime të rregullta dhe periodike brenda njësave dhe niveleve të ndryshme të institucionit;
  - 1.5. siguron që kërkesat e jashtme për sigurim të cilësisë zbatohen në gjitha nivelet dhe njësitë e institucionit;
  - 1.6. siguron që gjithë akterët e institucionit, përfshirë stafi akademik, stafi administrativ, studentët dhe palët e jashtme relevante janë pjesë përbërëse e proceseve të sigurimit të cilësisë;
  - 1.7. siguron që proceset e sigurimit të cilësisë janë pjesë përbërëse e aktiviteteve të rregullta të institucionit dhe kanë për qëllim përmirësimin e procesit mësimor brenda institucionit;
  - 1.8. siguron që institucioni ka në dispozicion mekanizma dhe instrumente të nevojshme, dhe se çdo proces i zyrës kryhet në bazë të të dhënave, informatave dhe statistikave të sakta të institucionit;
  - 1.9. siguron që të avancohet menaxhimi i informatave i cili sjell vendim-marrje efektive dhe të informuar brenda institucionit;
  - 1.10. siguron që politikat e digjitalizimit të procesit mësimor brenda institucionit të avancohen dhe se këto politika i hyjnë në shërbim ngritjes së cilësisë së procesit mësimor;

- 1.11. siguron që Standardet dhe Udhëzuesit Evropian të Sigurimit të Cilësisë (ESG) si dhe gjitha dokumentet e tjera të aplikueshme në Zonën Evropiane të Sigurimit të Cilësisë (EHEA) gjejnë zbatim të gjerë brenda institucionit;
  - 1.12. në bashkëpunim me gjithë akterët relevant angazhohet për krijimin dhe zhvillimin e kulturës së cilësisë brenda institucionit.
2. Zyra për sigurim të cilësisë përbëhet nga:
    - 2.1. Udhëheqësi i zyrës për sigurim të cilësisë
    - 2.2. Zyrtar për sigurim të cilësisë
  3. Udhëheqësi i zyrës për sigurim të cilësisë për punën e tij i përgjigjet Rektorit.
  4. Zyrtarët në zyrën për sigurim të cilësisë për punën e tyre i përgjigjen Udhëheqësit të zyrës për sigurim të cilësisë.

## **Neni 14**

### **Udhëheqësi i Zyrës për sigurim të cilësisë**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Udhëheqësit të Zyrës për sigurim të cilësisë janë:
  - 1.1. udhëheq me procesin e sigurimit të cilësisë brenda institucionit në pajtim me Strategjinë e Sigurimit të Cilësisë;
  - 1.2. përgatit dhe meanxhon të gjitha aktivitetet dhe proceset e lidhura me vlerësimin e brendshëm të institucionit;
  - 1.3. zbaton afatet kohore për kryerjen e proceseve të vlerësimit të brendshëm në nivele dhe njësi të ndryshme të institucionit të caktuara nga Komisioni për Sigurim të Cilësisë;
  - 1.4. administron dhe analizon pyetësor që kanë për qëllim vlerësimin e sektorëve të ndryshëm;
  - 1.5. është përgjegjës për hartimin e raporteve të ndryshme, informatave dhe analizave sa i përket vlerësimit të programeve të studimit;
  - 1.6. mirëmban të dhënat dhe statistikatat e gjeneruara nga vlerësimet e ndryshme në një bazë të të dhënave e cila mund të jetë e qasshme për menaxhmentin;
  - 1.7. koordinon agjendën e aktiviteteve me koordinatorët e cilësisë në nivel të Fakulteteve dhe degëve;
  - 1.8. siguron që gjitha proceset e sigurimit të cilësisë janë transparente dhe publike për akterët relevant;
  - 1.9. analizon rezultatet e raporteve të suksesit në afatet e provimeve dhe jep rekomandime periodike;
  - 1.10. jep rekomandime për rishikimin e programeve të studimit në bazën e të dhënave të gjeneruara nga vlerësimet e brendshme;

- 1.11. analizon plan – programet e studimeve dhe syllabuset për secilin departament dhe siguron që ato janë në përputhje me kërkesat e brendshme apo kërkesat e jashtme sipas legjislacionit në fuqi;
- 1.12. menaxhon procesin e akreditimit gjatë periudhës së vlerësimit të jashtëm;
- 1.13. bashkëpunon me Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) dhe përcjell në vazhdimësi procedurat dhe kërkesat e dala nga AKA;
- 1.14. bashkëpunon me Dekanët e fakulteteve si dhe koordinatorët e cilësisë së fakulteteve lidhur me çështjet profesionale të Zyrës;
- 1.15. mbikëqyr dhe përkrahë mësimdhënësit në zbatimin e planeve dhe programeve mësimore;
- 1.16. bën vlerësimin e rregullt të stafit nën mbikëqyrje të tij dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimit për kryerje të detyrave të tyre;

## **Neni 15**

### **Zyra qendrore për studentë**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrës qendrore për studentë janë:
  - 1.1. Organizon dhe koordinon punën e regjistrimit të studentëve;
  - 1.2. Organizon punën e zyrtarëve administrativ në shërbimin e studentëve;
  - 1.3. Lëshon vërtetime për statusin e studentëve, certifikata të notave dhe dokumente tjera për studentë;
  - 1.4. Përgatitë statistika të ndryshme për numrin e përgjithshëm të studenteve në të gjitha nivelet e studimeve;
  - 1.5. Njofton fakultetet për studentët e regjistruar dhe ata të transferuar;
  - 1.6. Lëshon vërtetime për statusin e studentëve;
2. Zyra qendrore për studentë përbëhet nga:
  - 2.1. Drejtori i zyrës qendrore për studentë
  - 2.2. Zyrtar administrativ
  - 2.3. Zyrtar për transfer të studentëve
  - 2.4. Asistent administrativ në shërbimin e informatave
3. Drejtori i zyrës qendrore për studentë për punën e tij i përgjigjet Rektorit.
4. Zyrtarët në zyrën qendrore për studentë për punën e tyre i përgjigjen dhe i raportojnë Drejtorit të zyrës qendrore për studentë.
5. Zyrtari administrativ gjatë kryerjes së detyrave dhe përgjegjësisë, i përgjigjet, pranon dhe kryen detyra edhe për dekanatin e fakultetit përkatës.

## **Neni 16**

### **Drejtori i zyrës qendrore për studentë**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të zyrës qendrore për studentë janë:
  - 1.1. është përgjegjësi kryesor për mbarëvajtjen e punëve dhe cilësinë e shërbimeve administrative për studentë;
  - 1.2. menaxhon aspektet administrative të procesit të regjistrimit të studentëve të rinj;
  - 1.3. menaxhon personelin e administratës;
  - 1.4. menaxhon dhe mirëmban bazën e të dhënave për studentë;
  - 1.5. propozon zhvillimin dhe avancimin e bazës së të dhënave të studentëve;
  - 1.6. përgatit statistika, raporte dhe pasqyra të ndryshme nga baza e të dhënave të studentëve;
  - 1.7. përpilon dhe mbikëqyrë vërtetimet, certifikatat, matrikulacionet dhe dokumentet e tjera që u lëshohen studentëve;
  - 1.8. në bashkëpunim me dekanatet dhe degët, përgatitë orarin e ligjëratave dhe orarin e provimeve;
  - 1.9. menaxhon transferet dhe rikthimet e studentëve;
  - 1.10. përditëson informatat e personelit për sektorin e administratës dhe i përcjell ato sipas nevojës dhe kërkesës;
  - 1.11. mbikëqyr punën e zyrtarëve administrativ për çështje të studentëve;
  - 1.12. merr pjesë aktivisht në zhvillimin dhe planifikimin institucional;
  - 1.13. zhvillon standarde për funksionimin e administratës dhe kujdeset për zbatimin e tyre;
  - 1.14. siguron ndërlidhjen e administratës me shërbimet financiare përkitazi me realizimin e kontratës së studentëve;
  - 1.15. menaxhon shërbimin e informatave (recepionit) brenda institucionit;
  - 1.16. përgatitë raporte të rregullta pune për menaxhmentin;
  - 1.17. publikon planin e punës në e-manager;
  - 1.18. përcjell trendët e zhvillimit të administratës;
  - 1.19. bën vlerësimin e rregullt të stafit nën mbikëqyrje të tij dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimit për kryerje të detyrave të tyre
  - 1.20. kujdeset për krijimin e raporteve të shëndosha në shërbimin e studentëve;

## **Neni 17**

### **Zyra për bashkëpunim të jashtëm**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrës për bashkëpunim të jashtëm janë:
  - 1.1. zbaton Strategjinë e Bashkëpunimit të jashtëm të institucionit;
  - 1.2. zhvillon politika dhe procese të bashkëpunimit të jashtëm në përputhje me Strategjinë e Bashkëpunimit të institucionit;

- 1.3. menaxhon proceset në lidhje me negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjeve vendore dhe ndërkombëtare;
  - 1.4. siguron pjesëmarrjen e institucionit në programet TEMPUS, ERASMUS e programe të tjera ndërkombëtare;
  - 1.5. përkujdeset në rritjen e ndërkombëtarizimit të institucionit;
  - 1.6. iniciacionin e franshizave dhe programeve të tjera me diploma të dyfishta;
  - 1.7. përkujdeset në ruajtjen dhe ngritjen e imazhit të institucionit jashtë vendit;
  - 1.8. përkujdeset në zhvillimin e bashkëpunimit ndëruniversitar ndërkombëtar;
  - 1.9. udhëheqë programin e shkollës verore;
  - 1.10. përgatitë marrëveshjet dhe protokollet e bashkëpunimit;
2. Zyra për bashkëpunim të jashtëm përbëhet nga:
- 2.1. Udhëheqësi i zyrës për bashkëpunim të jashtëm
  - 2.2. Zyrtar për bashkëpunim
  - 2.3. Zyrtar për aktivitete
  - 2.4. Zyrtar për mobilitet
3. Udhëheqësi i zyrës për bashkëpunim të jashtëm për punën e tij i përgjigjet Prorektorit për bashkëpunim të jashtëm.
4. Zyrtarët në zyrën për bashkëpunim të jashtëm për punën e tyre i përgjigjen Prorektorit për bashkëpunim të jashtëm, ndërsa për punët juridike dhe administrative konsultohen dhe i përgjigjen Sekretarit të përgjithshëm.

## **Neni 18**

### **Udhëheqësi i zyrës për bashkëpunim të jashtëm**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Udhëheqësit të zyrës për bashkëpunim të jashtëm janë:
  - 1.1. është përgjegjëse për gjitha proceset dhe procedurat e lidhura me bashkëpunimin e jashtëm të institucionit;
  - 1.2. ndihmon Prorektorin për bashkëpunim të jashtëm në hartimin e Strategjisë së Bashkëpunimit të jashtëm të institucionit;
  - 1.3. harton projekt propozime të cilat potencialisht mund të financohen nga palët e treta;
  - 1.4. në bashkëpunim me dekanët e fakulteteve përkatëse, menaxhon dhe koordinon gjitha proceset e lidhura me mobilitetin e studentëve dhe stafit akademik apo programeve të tjera të shkëmbimit;
  - 1.5. harton dhe implementon politikat, rregulloret dhe instrumentet e tjera për punën praktike të studentëve;
  - 1.6. në bashkëpunim me dekanët e fakulteteve përkatëse, menaxhon dhe koordinon gjitha proceset e lidhura me realizimin e punës praktike të studentëve



- 1.7. përkujdeset në rritjen e ndërkombëtarizimit të institucionit përmes aktiviteteve të cilat sigurojnë shkëmbimin e praktikave të mira mes universiteteve të ndryshme të Evropës dhe më gjerë
- 1.8. bashkë me sektorët tjerë, inicion zhvillimin e franshizave dhe programeve të tjera me diploma të dyfishta dhe diploma të përbashkëta me Universitete evropiane e të tjera ndërkombëtare;
- 1.9. në bashkëpunim me menaxhmentin e institucionit, angazhohet në hartimin dhe implementimin e programeve të studimit në gjuhë të huaja të cilat lehtësojnë dhe rrisin mobilitetin akademik të stafit dhe studentëve.

## **Neni 19**

### **Zyra për karrierë**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrës për karrierë janë:
  - 1.1. ofrimi i këshillimit të karrierës;
  - 1.2. organizimi i evenimenteve të punësimit;
  - 1.3. ndihma në përgatitjen për punësim;
  - 1.4. monitorimi i tendencave të tregut të punës;
  - 1.5. promovimi i mundësive për praktikë dhe punësim;
  - 1.6. ndihma në hartimin e CV-ve, letër-motivimit, plotësimit të aplikacioneve dhe zhvillimin e aftësive për intervistë;
  - 1.7. ndihma në identifikimin e rrugëve alternative për zhvillim në karrierë.
2. Zyra për karrierë përbëhet nga:
  - 2.1. Udhëheqësi i zyrës për karrierë
  - 2.2. Zyrtar për praktika të studentëve
  - 2.3. Zyrtar për karrierë
  - 2.4. Zyrtar për alumni
3. Udhëheqësi i zyrës për karrierë për punën e tij i përgjigjet Prorektorit për bashkëpunim të jashtëm.
4. Zyrtarët në zyrën për karrierë për punën e tyre i përgjigjen Udhëheqësit të zyrës për karrierë.

## **Neni 20**

### **Udhëheqësi i zyrës për karrierë**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e udhëheqësit të zyrës për karrierë janë:
  - 2.1. udhëheqë të punësuarit në zyrën për karrierë dhe koordinon detyrat e tyre;

- 2.2. harton dhe zbaton planet dhe strategjitë për të përmirësuar shërbimet dhe rezultatet e zyrës për karrierë;
- 2.3. ndërton dhe ruan marrëdhënie me organizata, kompani dhe institucione të ndryshme për të siguruar mundësi të punësimit dhe praktikave për studentët dhe të rinjtë;
- 2.4. përkujdeset në përmirësimin e aftësive dhe kompetencave të të punësuarve në zyrën për karrierë përmes trajnimeve dhe mentorimit;
- 2.5. harton dhe zbaton programe të ndryshme për të përmirësuar mundësitë e punësimit dhe zhvillimin e karrierës për studentët;
- 2.6. ofron këshilla për studentët në lidhje me zgjedhjen e karrierës dhe zhvillimin profesional;
- 2.7. publikon planin e punës në e-manager;
- 2.8. kryen edhe detyra tjera që i cakton mbikëqyrësi.

## **Neni 21**

### **Zyra për projekte**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrës për projekte janë:
  - 1.1. udhëheq dhe koordinon aktivitetin e stafit akademik gjatë ciklit të planifikimit dhe menaxhimit të projektit;
  - 1.2. ofron programe për ngritjen e kapacitetit të stafit akademik për planifikimin dhe menaxhimin e projekteve zhvillimore;
  - 1.3. përkujdeset për optimizimin e resurseve të brendshme gjatë planifikimit dhe menaxhimit të projekteve;
  - 1.4. është përgjegjëse për sigurimin e standardizimit dhe koherencës së të gjitha projekteve me ligjet, rregullat dhe rregulloret për institucionet e arsimit të lartë në Kosovë, si dhe dokumentet rregullative të AAB-së.
  - 1.5. sigurohet që projektet të jenë në përputhje me politikat dhe procedurat administrative dhe financiare të agjencive sponsorizuese.
2. Zyra për projekte përbëhet nga:
  - 2.1. Udhëheqësi i zyrës për projekte
  - 2.2. Zyrtar për projekte
  - 2.3. Zyrtar për buxhet dhe financa
3. Udhëheqësi i zyrës për projekte për punën e tij i përgjigjet Prorektorit për bashkëpunim të jashtëm.
4. Zyrtarët në zyrën për projekte për punën e tyre i përgjigjen Udhëheqësit të zyrës për projekte.

## **Neni 22**

### **Udhëheqësi i zyrës për projekte**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e udhëheqësit të zyrës për projekte janë:
  - 1.1. të përfaqësojë zyrën e projekteve përpara akterëve relevant;
  - 1.2. të identifikojë donatorët potencial dhe të analizojë thirrjet relavante për aplikim;
  - 1.3. të ndërtojë dhe mbajë kontakte të afërta me partnerët gjatë zhvillimit të projekteve;
  - 1.4. të zhvillojë konceptet e projekteve në përputhje me strategjinë e Kolegjit;
  - 1.5. të mbikëqyrë dhe koordinojë personelin e angazhuar në kuadër të zyrës;
  - 1.6. të raportojë para partnerëve dhe rektoratit rreth mbarëvajtjes së proceseve brenda zyrës;
  - 1.7. përkujdeset për identifikimin dhe kontraktimin e ekspertizës së jashtme kur kjo është e nevojshme dhe i shërben proceseve të brendshme të zyrës;
  - 1.8. është përgjegjës për të siguruar pajtueshmërinë e të gjitha projekt-propozimeve që burojnë nga Kolegji AAB;
  - 1.9. merr pjesë në të gjitha negociatat e kontraktimit, duke përfshirë negociatat për shpenzimet indirekte me agjencitë financuese ose sponsorët;
  - 1.10. mbikëqyrë implementimin e të gjitha projektet e mbështetura nga fondet e jashtme në Kolegjin AAB.

## **Neni 23**

### **Zyra për financa**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrës së financave janë:
  - 1.1. koordinon punën me të gjitha zyrat tjera dhe fakultetet për përpunimin e kërkesave financiare;
  - 1.2. bën regjistrimin e të gjitha shpenzimeve të mallrave dhe shërbimeve sipas kategorive, kryen shpenzimet komunale, transferime, subvencionet, grantet, pagesat e ndryshme, planifikimet e shpenzimeve etj.
  - 1.3. përgatit pasqyrat financiare, raportet periodike dhe vjetore për Këshillin Drejtues;
  - 1.4. furnizon të gjitha zyrat dhe njësitë tjera me mjete teknike të nevojshme;
  - 1.5. menaxhon dhe ruan dokumentacionin financiar siç e parasheh legjislacioni në fuqi;
  - 1.6. e koordinon punën mes njësive dhe siguron se të gjitha kërkesat për furnizim për mallra, shërbime, punë apo shërbime tjera janë në rregull dhe të bëra nga personat përgjegjës;
  - 1.7. ofron këshilla që kanë të bëjnë menaxhimin e financave nga njësitë tjera;
  - 1.8. përkujdeset për buxhetin, planifikimin financiar, analizat financiare dhe resurset tjera.

2. Zyra për financa përbëhet nga:
  - 2.1. Drejtori i zyrës për financa
  - 2.2. Zyrtari i financave
  - 2.3. Kontabilisti
  - 2.4. Arkëtari
  - 2.5. Koordinator i për rikthim të studentëve
  - 2.6. Zyrtari për rikthim të studentëve
3. Drejtori i zyrës për financa për punën e tij i përgjigjet Prorektorit për financa, ndërsa për punët juridike dhe administrative obligohet të konsultohet dhe koordinohet me Sekretarin e përgjithshëm.
4. Zyrtarët në Zyrën për financa për punën e tyre i përgjigjen Drejtorit të zyrës për financa.

## **Neni 24**

### **Drejtori i zyrës për financa**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit të zyrës për financa janë:
  - 1.1. mbikëqyrë dhe organizon punën në drejtorinë e financave dhe furnizimit;
  - 1.2. kujdeset për realizimin e të hyrave të institucionit;
  - 1.3. harton raporte për stafin menaxhues në baza periodike dhe sipas kërkesës së menaxhmentit;
  - 1.4. monitoron dhe menaxhon shpenzimet në kuadër të buxhetit të alokuar;
  - 1.5. bashkëpunon ngushte me prorektorin për zhvillim dhe financa në përgatitjen e planit vjetor dhe buxhetit të institucionit;
  - 1.6. zbaton pagesat për projektet dhe nismat e miratuara studentore;
  - 1.7. mbikëqyrë aspektet financiare të shërbimit për studentë;
  - 1.8. organizon dhe mirëmban dosjet dhe të dhënat financiare;
  - 1.9. propozon rishikimin dhe plotësimin e rregulloreve dhe procedurat financiare;
  - 1.10. përgatitë dhe ekzekuton pagesat e institucionit;
  - 1.11. kontrollon të ardhurat, paratë e gatshme dhe shpenzimet;
  - 1.12. përcjell gjendjen financiare të institucionit në çdo kohë nën udhëheqjen e prorektorit për financa;
  - 1.13. përpilon dhe dorëzon listat e pagesave për procesim të mëtutjeshëm;
  - 1.14. shqyrton dhe aprovon kërkesat e studentëve për lehtësira financiare sipas kërkesave të veçanta;
  - 1.15. përcjellë implementimin e drejtë të zbritjeve në sistem;
  - 1.16. bashkëpunon dhe mban kontakte me banka dhe institucione të tjera financiare;
  - 1.17. përcjellë inkasimin e mjeteve në afate të caktuara kohore;

- 1.18. përgatitë raporte dhe analiza financiare sipas kërkesës së prorektorit për zhvillim dhe financa;
- 1.19. dorëzon listën e pagave të kontabilistit për raportim në ATK;
- 1.20. mbikëqyrë, kontrollon dhe barazon arkat;
- 1.21. organizon deponimin e cash-it në banke;
- 1.22. përgatitë raportet e blerjeve, që duhet të aprovohen nga prorektori për zhvillim dhe financa;
- 1.23. shqyrton ankesat në lidhje kryerjen e pagesave të ndryshme për personelin;
- 1.24. bashkëpunon me departamentin e administratës për realizimin e kushteve financiare të kontratës së studentit;
- 1.25. verifikon saktësinë e faturave dhe pagesave;
- 1.26. menaxhon aktivitete ditore administrative dhe financiare;
- 1.27. proceson në kohë pagesat e faturave;
- 1.28. siguron që të gjitha kërkesat e raportimit financiar të brendshëm dhe të jashtëm janë përmbushur në kohën e duhur dhe me rregull;
- 1.29. mbikëqyrë hartimin e deklaratave mujore, tremujore dhe vjetore për Administratën Tatimore të Kosovës;
- 1.30. identifikon dhe jep zgjidhje për të gjitha çështjet financiare;
- 1.31. publikon planin e punës në e-menagjer
- 1.32. bën vlerësimin e rregullt të stafit nën mbikëqyrje të tij dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimit për kryerje të detyrave të tyre
- 1.33. kryen detyra të tjera sipas kërkesës së eprorit.

## **Neni 25**

### **Zyra për marketing**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrës për marketing janë:
  - 1.1. Zyra për marketing organizon aktivitete promovuese dhe aktivitetet e përgjegjësisë sociale;
  - 1.2. Bënë organizime të aktiviteteve të studentëve brenda dhe jashtë kampusit;
  - 1.3. Bënë organizime të ndryshme të maturantëve si dhe i informon në lidhje me konkursin dhe gjëra tjera në interes të tyre;
  - 1.4. Bënë organizimin e ditëve të AAB-së;
  - 1.5. Bënë organizimin e ahengjeve apo party të ndryshme, brenda dhe jashtë kampusit;
  - 1.6. Bënë organizimin, menaxhimin dhe shpërndarjen e të gjitha reklamave;
  - 1.7. Bënë arkivimin e të gjitha materialeve në lidhje me aktivitetet, apo të ngjashme;
  
2. Zyra për marketing përbëhet nga:
  - 2.1. Drejtori i zyrës për marketing
  - 2.2. Përgjegjësi i sektorit

- 2.3. Zyrtar për marketing
  - 2.4. Agjent i marketingut
3. Drejtori i zyrës për marketing për punën e tij i përgjigjet Prorektorit për planifikim dhe zhvillim, ndërsa për punët juridike dhe administrative obligohet të konsultohet dhe koordinohet me Sekretarin e përgjithshëm.
  4. Punëtorët në Zyrën për marketing për punën e tyre i përgjigjen Drejtorit të zyrës për marketing.

## **Neni 26**

### **Drejtorit i zyrës për marketing**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit të zyrës për marketing janë:
  - 1.1. Planifikon dhe harton konceptin, politikat dhe strategjinë e marketingut;
  - 1.2. Harton buxhetin vjetor për marketing;
  - 1.3. Mbikëqyrë, organizon dhe vlerëson personelin e marketingut;
  - 1.4. Zbaton strategjitë dhe aktivitetet në fushën e marketingut;
  - 1.5. Udhëheq fushatat promovuese të institucionit;
  - 1.6. Koordinon procesin e përgatitjes së çdo lloj materiali promovues (audio, video, të shkruar, media sociale etj.);
  - 1.7. Organizon dhe mirëmban bazën e të dhënave të sektorit të Marketingut;
  - 1.8. Shqyrton dhe nënshkruan kontratat që kanë të bëjnë me marketingun, në bashkëpunim me Rektoren, Prorektorin për planifikim dhe zhvillim dhe Sekretarin;
  - 1.9. Merr pjesë në hartimin e politikave të pagesave për studime dhe bursave për student të rinj;
  - 1.10. Merr pjesë në takime për planifikime strategjike të menaxhmentit;
  - 1.11. Merr pjesë në vendimet në nivel Rektorati që ndërlidhen me fushën e marketingut;
  - 1.12. Koordinon aktivitetet për përgjegjësi sociale kooperative;
  - 1.13. Përcjell trendët në fushën e marketingut, përfshirë marketingun digjital dhe social, dhe propozon ide për zhvillim të zyrës së marketingut,
  - 1.14. Identifikon partnerët strategjik sipas kriterëve të fushës që mbulon;
  - 1.15. Vlerëson nevojat dhe organizon ngritjen e kapaciteteve të personelit;
  - 1.16. Menaxhon qendrat e regjistrimeve jashtë kampusit të institucionit;
  - 1.17. Përgatit analiza të tregut, të konkurrencës, të çmimeve, të kënaqshmërisë së studentëve dhe ia prezanton ato të dhëna menaxhmentit;
  - 1.18. Krijon marrëdhënie bashkëpunimi me shkollat e nivelit parauniversitarë;
  - 1.19. Harton raporte me statistika në baza periodike;
  - 1.20. Kujdeset që aktivitetet e marketingut të janë konform afateve të përcaktuara dhe brenda buxhetit të përcaktuar;
  - 1.21. Organizon menaxhimin efikas të inventarit në fushën e marketingut;
  - 1.22. Bën planifikimin e personelit për nevoja të aktiviteteve të sektorit;

- 1.23. Publikon planin e punës në E-Manager;
- 1.24. Bën vlerësimin e rregullt të stafit nën mbikëqyrje të tij dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimit për kryerje të detyrave të tyre;
- 1.25. Kryen edhe detyra të tjera të caktuara nga mbikëqyrësi.

## **Neni 27**

### **Zyra për shërbime mbështetëse**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrës për shërbime mbështetëse janë:
  - 1.1. ofron mbështetje teknik për të gjitha zyrat dhe njësit akademike;
  - 1.2. mbikëqyrë dhe menaxhon hapësirat e kampusit;
  - 1.3. përgatit raporte periodike dhe vjetore për rektorin;
  - 1.4. planifikon detyrat dhe përgjegjësitë e punëtorëve të zyrës për mbështetje teknike;
  - 1.5. kujdeset për funksionimin e rregullt të pajisjeve teknike;
  - 1.6. kujdeset për mbajtjen e hixhienës në hapësirën e kampusit;
  - 1.7. kujdeset për krijimin e një ambienti të sigurt dhe të përshtatshëm pune për të gjithë të punësuarit, studentët dhe stafin akademik;
2. Zyra për shërbime mbështetëse përbëhet nga:
  - 2.1. Njësia e shërbimeve mbështetëse, e cila përbëhet nga këta zyrtar:
    - a. Menaxheri i shërbimeve mbështetëse
    - b. Punëtor në shërbimin teknik
    - c. Vozitës
    - d. Punëtor i sigurimit
    - e. Punëtor i higjienës
  - 2.2. Njësia e furnizimi, e cila përbëhet nga këta zyrtar:
    - a. Menaxheri i furnizimit
    - b. Zyrtar për furnizim
    - c. Zyrtar për regjistrim të inventarit
3. Menaxheri i shërbimeve mbështetëse dhe Menaxheri i furnizimit, për punën e tyre i përgjigjen Prorektorit për planifikim dhe zhvillim, ndërsa për punët juridike konsultohet dhe i përgjigjet Sekretarit të përgjithshëm.
4. Punëtorët në Zyrës për shërbime mbështetëse për punën e tyre i përgjigjen Menaxherëve të njësisë.

## Neni 28

### Menaxheri i shërbimeve mbështetëse

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Menaxherit të shërbimeve mbështetëse janë:
  - 1.1. përgjegjës për mbarëvajtjen dhe cilësinë e shërbimeve mbështetëse në institucion;
  - 1.2. përgjegjës për krijimin e një ambienti të sigurt dhe të përshtatshëm pune për të gjithë të punësuarit, studentët dhe stafin akademik;
  - 1.3. përgjegjës për mbikëqyrjen e kamerave të sigurisë në kampuse të institucionit;
  - 1.4. mbikëqyrë, menaxhon dhe kontrollon hapësirat e kampuseve;
  - 1.5. përgjegjës për hapësirat e gjelbëruara të institucionit;
  - 1.6. koordinon të gjitha aktivitetet në lidhje me akomodimin brenda kampusit dhe regjistrimin e inventarit;
  - 1.7. është përgjegjës për sigurimin e servisimit dhe mirëmbajtjes së mjeteve transportuese në institucion;
  - 1.8. kujdeset për realizimin e të gjitha kërkesave të personelit lidhur me transportin;
  - 1.9. përgjegjës për regjistrimin, ruajtjen, kontrollimin dhe menaxhimin e gjithë inventarit për të gjitha kampuset e institucionit;
  - 1.10. krijon kushte për funksionimin adekuat të pajisjeve teknike dhe mjeteve motorike në të gjitha kampuset e institucionit;
  - 1.11. përgjegjës për pastërtinë dhe cilësinë e shërbimeve në bufet e institucionit;
  - 1.12. mbikëqyr dhe organizon higjienën në qendër dhe në degë;
  - 1.13. mbikëqyr, organizon, dhe menaxhon transportin për bartjen e studentëve;
  - 1.14. menaxhon punën e personelit teknik;
  - 1.15. menaxhon shërbimet teknike në degë në bashkëpunim me drejtorin e degës;
  - 1.16. përpilon raporte periodike sipas kërkesës së mbikëqyrësit dhe nevojave të paraqitura;
  - 1.17. përfaqëson institucionin në kontakte me palët e treta në fushëveprimin e vet;
  - 1.18. ofron mbështetje për të gjitha organizimet e institucionit;
  - 1.19. publikon planin e punës në e-manager;
  - 1.20. përcjell trendët dhe zhvillimet në sektorin e shërbimeve teknike;
  - 1.21. përkujdeset për ruajtjen dhe ngritjen e imazhit të institucionit;
  - 1.22. menaxhon auto shkollën e institucionit;
  - 1.23. vlerëson nevojat dhe rekruton personelin për sektorin e shërbimeve teknike;
  - 1.24. vlerëson nevojat e personelit për ngritje të kapaciteteve dhe organizon aktivitete aftësuese;
  - 1.25. bën vlerësimin e rregullt të stafit nën mbikëqyrje të tij dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimit për kryerje të detyrave të tyre;
  - 1.26. kryen edhe punë tjera që i cakton mbikëqyrësi.



## Neni 29

### Menaxheri i furnizimit

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Menaxherit të furnizimit janë:
  - 1.1. Koordinon dhe menaxhon të gjitha aktivitetet e furnizimit ne institucion;
  - 1.2. Planifikon, udhëheqë dhe koordinon punën e zyrtarëve të furnizimit dhe punëtorëve tjerë të kyçur në furnizimin e produkteve;
  - 1.3. Është përgjegjës kryesor për të gjitha furnizimet, përfshirë furnizimin e personelit administrativ dhe mësimor me materialet dhe mjetet e nevojshme teknike;
  - 1.4. Mbledh ofertat dhe negocion marrëveshjet për të arritur kostot më të ulëta të mundshme të blerjes;
  - 1.5. Mbanë të dhënat për përdorimin, sevisimin e automjeteve të institucionit dhe përgatit dokumentet e nevojshëm për përdorimin e tyre;
  - 1.6. Përgjegjës për pranimin e të gjitha faturave që vijnë në emër të institucionit;
  - 1.7. Koordinon gjithë procesin e pagesave të faturave;
  - 1.8. Koordinon dhe menaxhon projektet për ndërtim, zgjerim dhe renovim të hapësirave te institucionit;
  - 1.9. Siguron rregullsinë e procedurave për fillimin e punëve, përfshirë lejen për ndërtim;
  - 1.10. Organizon mbikëqyrjen e punimeve;
  - 1.11. Mbikëqyr rregullsinë e procedurave të furnizimit;
  - 1.12. Është përgjegjës për përditësimin e kartelave të kontraktuesve dhe furnitorëve;
  - 1.13. Përgatitë pikat kyçe te kontratave për furnizim në bashkëpunim me sekretarin;
  - 1.14. Harton plane dhe raporte të rregullta për të gjitha aktivitetet e furnizimit;
  - 1.15. Përgatitë raportin për pagesa që kanë të bëjnë me shpenzimet për furnizim dhe shërbimet e pagesave mujore;
  - 1.16. Propozon forma apo ide për zvogëlimin e kostove dhe harton plane për kursim;
  - 1.17. Menaxhon dhe kontrollon ndryshimin e çmimeve nga ana e furnitorëve konform kushteve të kontratës/ marrëveshjes;
  - 1.18. Organizon procesin e porosive të mallrave qofshin ato sistematike apo të shpejta, elektronike apo të drejtpërdrejta, nga furnitorët;
  - 1.19. Publikon planin e punës në E-manager;
  - 1.20. Kryen edhe punë tjera që i cakton mbikëqyrësi;

## Neni 30

### Zyra për teknologji

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrës për teknologji janë:
  - 1.1. zhvillon dhe vendos standarde në lidhje me harduerin, softuerin, rrjetin dhe bazën e të dhënave;
  - 1.2. planifikon dhe propozon projekte të fushës së teknologjisë së informacionit për nevoja të institucionit;
  - 1.3. koordinon zbatimin dhe mirëmbajtjen e projekteve të TI-së;
  - 1.4. planifikon, dizajnon, integron, bart, freskon, menaxhon dhe mbështet sistemet dhe kërkesat e teknologjisë së informacionit, duke përfshirë edhe edukimin elektronik;
  - 1.5. udhëheqë dhe koordinon procesin e freskimit dhe elaborimit të vazhdueshëm të strategjisë së edukimit elektronik, duke propozuar dhe zbatuar aplikacione për mësim në distancë (e-learning);
  - 1.6. zhvillon program të aplikueshëm sipas standardeve dhe nevojave për udhëheqjen e lehtë dhe të efektshme të bazave të të dhënave për studentë, për personelin akademik dhe administrativ;
  - 1.7. trajnon, këshillon dhe informon stafin akademik, administrativ dhe studentët për përdorimin e programeve dhe aplikacioneve të zhvilluara;
  - 1.8. mirëmban pajisjet e teknologjisë së informacionit;
  - 1.9. të gjitha programet që zhvillohen nga zyra, bëhen në koordinim me udhëheqësit e departamenteve përkatëse.
2. Zyra për teknologji udhëhiqet dhe menaxhohet nga Drejtori i zyrës për teknologji
3. Zyra për teknologji përbëhet nga:
  - 4.1. Njësia e zhvillimit të softuerit, e cila përbëhet nga këta zyrtar:
    - a. Përgjegjësi i njësisë
    - b. Zhvillues i softuerit
  - 4.2. Njësia e infrastrukturës dhe komunikimit, e cila përbëhet nga këta zyrtar:
    - a. Përgjegjësi i njësisë
    - b. Specialist i rrjetave
    - c. Teknik i harduerit
  - 4.3. Njësia e sigurisë kibernetike, e cila përbëhet nga këta zyrtar:
    - a. Përgjegjësi i njësisë dhe
    - b. Teknik i sigurisë kibernetike
4. Drejtori për teknologji për punën e tij i përgjigjet Prorektorit planifikim dhe zhvillim, ndërsa drejtpërdrejtë pranon detyra edhe nga Prorektorët tjerë dhe Sekretari për punët që ndërlidhen me sektorët e tyre.

5. Ligjëruesi dhe asistentët e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike angazhohen në Zyrën për teknologji. Angazhimi i tyre nuk duhet të tejkaloj në asnjë rast 20% e orarit të plotë të punës, apo 8 orë punë në javë.
6. Punëtorët në Zyrën për teknologji për punën e tyre i përgjigjen Drejtorit të zyrës për teknologji.

## **Neni 31**

### **Drejtori i zyrës për teknologji**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të zyrës për teknologji janë:
  - 1.1. kontribuon në planifikimin dhe mbarëvajtjen e punës në departamentin e teknologjisë informative;
  - 1.2. mbikëqyr të gjitha operacionet e teknologjisë (sigurinë e rrjetit, mirëmbajtjen dhe zhvillimin softuerik);
  - 1.3. harton plane dhe politika për sistemet e ti-së, për të mbështetur zbatimin e strategjive të vendosura nga menaxhmenti i lartë, dhe për të përmirësuar efikasitetin e punës;
  - 1.4. zhvillon, implementon, instalon dhe mirëmban aplikacionet sipas kërkesave të sektorëve;
  - 1.5. është përgjegjës për evitimin dhe zgjidhjen e problemeve teknologjike të cilat paraqiten në pajisjet teknologjike dhe aplikacionet softuerike;
  - 1.6. është përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave;
  - 1.7. është përgjegjës për funksionimin efikas dhe mirëmbajtjen e rrjetit të institucionit;
  - 1.8. siguron funksionim të mirë dhe të shpejtë të aplikacioneve dhe të internetit;
  - 1.9. zhvillon, mirëmban dhe mbikëqyrë procedurat për të gjitha kopjet rezervë (backups) të serverit;
  - 1.10. koordinon furnizimin, instalimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e pajisjeve teknologjike të institucionit;
  - 1.11. propozon dhe inicion zhvillimin e aplikacioneve të reja;
  - 1.12. ofron mbështetje teknike për përdoruesit dhe organizon trajnime për përdorimin e programeve e aplikacioneve specifike;
  - 1.13. identifikon dhe koordinon nevojën për përmirësime, konfigurime dhe sisteme dhe pajisje të reja teknologjike të institucionit;
  - 1.14. ndihmon në ndërtimin e marrëdhënieve me shitësit dhe krijimin e kontratave me kosto efektive;
  - 1.15. përcjell zhvillimet më të reja në fushën e teknologjisë, dhe implementon ato njohuri në sistemet aktuale;
  - 1.16. ruan konfidencialitetin e të dhënave të institucionit;
  - 1.17. përpilon raporte periodike sipas kërkesës së mbikëqyrësit;
  - 1.18. publikon planin e punës në e-manager;

- 1.19. planifikon dhe koordinon mirëmbajtjen parandaluese dhe të rregullt të pajisjeve të ti-së, servisimin e prishjeve, gjetjen e zgjidhjeve të përkohshme për funksionim të pandërprerë të procesit të punës deri në zgjidhjet përfundimtare të problemeve teknike;
- 1.20. kujdeset për ruajtjen dhe ngritjen e imazhit të institucionit;
- 1.21. vlerëson kërkesat dhe rekruton personelin për sektorin e shërbimeve teknologjike;
- 1.22. vlerëson nevojat e personelit për ngritje të kapaciteteve dhe organizon aktivitete aftësuese;
- 1.23. bën vlerësimin e rregullt të stafit nën mbikëqyrje të tij dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimit për kryerje të detyrave të tyre;
- 1.24. kryen edhe punë tjera që i cakton mbikëqyrësi sipas fushës së përgjegjësisë së vet.

## **Neni 32**

### **Zyra për marrëdhënie me publikun**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrës për marrëdhënie me publikun janë:
  - 1.1. funksioni kryesor i ZMP është organizimi i komunikimit institucional të AAB-së me publikun;
  - 1.2. kujdeset për vendosjen dhe forcimin e marrëdhënieve me median;
  - 1.3. ZMP është përgjegjëse për përgatitjen dhe publikimin e materialeve promovuese të institucionit, si fletëpalosje, broshura, katalogë, raport aktivitetesh, albume etj;
  - 1.4. bën mbledhjen, përpunimin dhe publikimin e informatave për aktivitetet kryesore të përditshme;
  - 1.5. bashkëpunon me zyrat dhe sektorët tjerë për mbledhjen e informacioneve për plasim sa më të shpejt në opinionin publik;
  - 1.6. bënë hartimin e informatave të shkurtra nga sektorët dhe fakultetet përkatëse;
  - 1.7. bënë hartimin e artikujve dhe tregimeve të suksesshme për punën në institucion;
  - 1.8. bënë publikimin e informacioneve dhe të tregimeve të suksesit në web faqe dhe në rrjetet sociale;
  - 1.9. bashkëpunon me zyrën për marketing dhe zyrën për bashkëpunim të jashtëm për shpërndarjen me kohë të informacioneve dhe për ndërtimin e imazhit pozitiv në opinionin publik;
  - 1.10. bënë arkivimin e të gjitha publikimeve;
  - 1.11. përgatit raporte periodike dhe vjetore për Rektorin;
  - 1.12. këshillon rektorin për çështje që kanë të bëjnë me informimin dhe komunikimin.
2. Zyra për marrëdhënie me publikun përbëhet nga:

- 2.1. Drejtori i zyrës për marrëdhënie me publikun
  - 2.2. Gazetar/Redaktor
  - 2.3. Administratori i uebit
  - 2.4. Dizajner grafik
  - 2.5. Realizator
  - 2.6. Kamerman/Montazher
  - 2.7. Fotograf
  - 2.8. Zyrtar për protokoll
  - 2.9. Lektor
  - 2.10. Specialist i mediave sociale dhe digjitale
3. Drejtori i zyrës për marrëdhënie me publikun për punën e tij i përgjigjet Prorektorit planifikim dhe zhvillim, ndërsa drejtpërdrejtë pranon detyra edhe nga Prorektorët tjerë dhe Sekretari për punët që ndërlidhen me sektorët e tyre.
  4. Punëtorët në zyrën për marrëdhënie me publikun për punën e tyre i përgjigjen Drejtorit të zyrës për marrëdhënie me publikun.
  5. Lektor pranon detyra edhe nga Prorektorët tjerë dhe Sekretari për punët që ndërlidhen me sektorët e tyre.

### **Neni 33**

#### **Drejtori i zyrës për marrëdhënie me publikun**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të zyrës për marrëdhënie me publikun janë:
  - 1.1. është përgjegjës për krijimin dhe ekzekutimin e strategjive për të ruajtur dhe promovuar imazhin e institucionit dhe për të ndërtuar marrëdhënie të mira me publikun, median dhe palët e tjera të interesuara;
  - 1.2. është përgjegjës për hartimin e njoftimeve për shtyp, përgjigjen ndaj pyetjeve të medias dhe organizimin e konferencave ose ngjarjeve për shtyp;
  - 1.3. përkujdeset për zhvillimin e komunikimit efektiv brenda institucionit duke zhvilluar dhe zbatuar strategji dhe kanale të komunikimit të brendshëm;
  - 1.4. është përgjegjës për komunikimin dhe lidhjen e institucionit me publikun nëpërmjet medias, rrjeteve sociale, takimeve publike, dhe komunikimeve të tjera;
  - 1.5. është përgjegjës për menaxhimin e informacionit të institucionit që është në interes të publikut dhe për zbatimin e ligjeve për transparencë dhe qasjen në informacion;
  - 1.6. është përgjegjës për trajtimin e pyetjeve të publikut në lidhje me institucionin dhe për ofrimin e përgjigjeve dhe ndihmës në kohë të duhur;
  - 1.7. planifikon dhe organizon aktivitete të ndryshme për të rritur ndërgjegjësimin dhe ndërtimin e marrëdhënieve me publikun;

- 1.8. ofron këshillim dhe mbështetje për rektoratin, fakultetet etj, për të përmbushur detyrat e tyre në lidhje me marrëdhëniet me publikun;
- 1.9. mbikëqyrë punën e stafit të zyrës për marrëdhënie me publikun, duke përfshirë caktimin e detyrave, ofrimin e udhëzimeve dhe vlerësimin e performancës.

## **Neni 34**

### **Zyra për diploma**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrës për diploma janë:
  - 1.1. përgatitja dhe hartimi i diplomave dhe dokumenteve të tjera të certifikimit për studentët që kanë përfunduar me sukses studimet;
  - 1.2. verifikimi i dosjes dhe rezultateve të studentëve për të siguruar që ata përmbushin kriteret për të marrë diplomën, certifikatën e diplomimit, shtojcën e diplomës;
  - 1.3. mbajtja e regjistrave dhe librave amë për të gjithë studentët që kanë marrë diplomën ose dokumentet tjera;
  - 1.4. bashkëpunimi dhe koordinimi i punës me fakultetet dhe departamentet e tjera për të siguruar që procesi i lëshimit të diplomave të zhvillohet pa probleme;
  - 1.5. kujdeset për zbatimin e politikave dhe procedurave të institucionit për lëshimin e diplomave dhe dokumenteve të tjera relevante për studentët;
  - 1.6. përdorimi dhe menaxhimi i sistemeve të informacionit për të mbështetur procesin e lëshimit të diplomave.
2. Zyra për diploma përbëhet nga:
  - 2.1. Udhëheqësi i zyrës për diploma
  - 2.2. Zyrtar për diploma
  - 2.3. Zyrtar për arkiva
3. Udhëheqësi i zyrës për diploma për punën e tij i përgjigjet Sekretarit të përgjithshëm.
4. Punëtorët në zyrën për diploma për punën e tyre i përgjigjen Udhëheqësit të zyrës për diploma.

## **Neni 35**

### **Udhëheqësi i zyrës për diploma**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Udhëheqësit të zyrës për diploma janë:
  - 1.1. kujdeset për zbatimin e procedurave të pajisjes me diplomë;
  - 1.2. udhëzon studentët për procedurat e pajisjes me diplomë;

- 1.3. trajton kërkesat e studentëve për pajisje me certifikatë dhe diplomë;
- 1.4. siguron që diplomat e lëshuara për studentë janë në përputhje të plotë me vendimet e institucionit, AKA dhe MASHTI;
- 1.5. përgatitë shtojcën e diplomës për studentë;
- 1.6. bën verifikimin e saktësisë së diplomave dhe dokumentacionit tjetër të studentëve të diplomuar sipas kërkesave të institucioneve të jashtme;
- 1.7. kontrollon dosjen e studentit diplomant përfshirë kronologjinë e studimeve, dokumentacionin e shkollimit paraprak, origjinalitetin e tyre, vitet e përfunduara të studimit, plan programin dhe ECTS-të, obligimet kontraktuale financiare të studentit – kontrollimi i pagesave;
- 1.8. lëshon vërtetime për studentët aktual dhe të diplomuar sipas kërkesave;
- 1.9. kujdeset për arkivimin e dosjes së studentit pas diplomimit;
- 1.10. plotëson dokumentacionin e nevojshëm për studentët e diplomuar që i nënshtrohen verifikimit nga MASHTI;
- 1.11. plotëson, ruan dhe mirëmban librat amë të studentëve;
- 1.12. publikon planin e punës në e-manager;
- 1.13. kryen edhe punë të tjera që i cakton mbikëqyrësi.

### **Neni 36**

#### **Zyra për personel**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrës për personel janë:
  - 1.1. bënë administrimin dhe menaxhimin e përgjithshëm të zyrës për personel dhe siguron që të përmbushen detyrat në mënyrë efektive;
  - 1.2. në bashkëpunim me zyrat dhe sektorët tjerë, kontribuon në rritjen e performancës së personelit, nëpërmjet motivimit dhe zhvillimit të planeve trajnuese;
  - 1.3. menaxhon dhe mirëmban informatat për burimet njerëzore, asiston menaxhmentin në organizimin e brendshëm, ofron mbështetje administrative dhe të logjistikës;
  - 1.4. siguron zbatimin e procedurave për rekrutim dhe përzgjedhje, disiplinë, trajtim të ankesave, kërkesave të pushimit, vlerësimit të punës etj;
  - 1.5. menaxhon mbrojtjen dhe përpunimin e të dhënave personale sipas legjislacionit në fuqi;
  - 1.6. në bashkëpunim me zyrat dhe sektorët tjerë, organizon trajnime për stafin e institucionit;
  - 1.7. menaxhon sistemin e arkivit dhe dokumentet e brendshme të institucionit;
  - 1.8. Ofron shërbime logjistike për institucionin dhe ministrinë.
  
2. Zyra për personel përbëhet nga:
  - 2.1. Zyrtari i personelit
  - 2.2. Zyrtari juridik

3. Zyrtarët e zyrës për personel për punën e tyre i përgjigjen Sekretarit të përgjithshëm.

### **Neni 37**

#### **Biblioteka universitare**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Bibliotekës universitare janë:
  - 1.1. Biblioteka universitare mbledhë, përpunon dhe ofron në përdorim koleksione mësimore, materiale, informacione dhe shërbime bibliotekare për zhvillimin e veprimtarisë arsimore, shkencore si dhe për zhvillimin e aftësive dhe njohurive të studenteve e mësimdhënësve;
  - 1.2. Biblioteka universitare ofron shërbime për studentë dhe personelin akademik duke huazuar materiale bibliotekare dhe duke siguruar qasje në burimet elektronike;
2. Biblioteka universitare përbëhet nga:
  - 2.1. Drejtori i bibliotekës
  - 2.2. Zyrtarë në bibliotekë
  - 2.3. Zyrtarë në librari
3. Drejtori i bibliotekës për punën e tij i përgjigjet dhe i raporton Prorektorit për shkencë, ndërsa për punët juridike dhe administrative konsultohet dhe i përgjigjet Sekretarit të përgjithshëm.
4. Punëtorët e bibliotekës për punën e tyre i përgjigjen dhe i raportojnë Drejtorit të bibliotekës.

### **Neni 38**

#### **Drejtori i bibliotekës**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të bibliotekës janë:
  - 1.1. Udhëheqë dhe përfaqëson bibliotekën dhe librarinë;
  - 1.2. Menaxhon sistemin dhe mirëmbajtjen e librave në bibliotekë dhe librari;
  - 1.3. Organizon furnizimin e librarisë;
  - 1.4. Menaxhon shitjen dhe distribuimin e librit;
  - 1.5. Krijon politika për zhvillimin e koleksioneve;
  - 1.6. Propozon projekte, që vlerësojnë nevojat e studentëve dhe përdoruesve duke i përshtatur me nevojat e fakulteteve;
  - 1.7. Merr pjese në hartimin dhe rishikimin e rregulloreve që ndërlidhen me sektorin e librit dhe kujdeset për zbatimin e tyre;



- 1.8. Në bashkëpunim me studentët, fakultetet dhe përdoruesit përzgjedh materialet për zhvillimin e koleksioneve;
- 1.9. Hulumton për burimet elektronike dhe propozon anëtarësimin në burimet përkatëse.
- 1.10. Mirëmban bazën e të dhënave elektronike në bibliotekë;
- 1.11. Siguron burime elektronike duke lidhur kontrata me platforma të ndryshme;
- 1.12. Bënë prezantime për studentë dhe stafin akademik në lidhje me shfrytëzimin e shërbimeve të bibliotekës;
- 1.13. Harton udhëzues për studentë dhe stafin akademik për shfrytëzimin e shërbimeve të bibliotekës;
- 1.14. Harton strategji për promovimin dhe vetëdijësimin për leximin e librit në kuadër të institucionit dhe jashtë tij (edhe si pjesë e marketingut);
- 1.15. Menaxhon aktivitetet e librit, panairët dhe shënimin e ditëve të librit;
- 1.16. Në bashkëpunim me Këshillin Botues dhe Zyrën për marrëdhënie me publikun, bënë promovimin e botimeve të reja;
- 1.17. Mirëmban dhe përditëson web faqen e bibliotekës;
- 1.18. Planifikon dhe menaxhon buxhetin e bibliotekës;
- 1.19. Kontrollon dhe menaxhon ruajtjen dhe qarkullimin e librave
- 1.20. Menaxhon shërbimin e informacionit dhe përdorimin e resurseve;
- 1.21. Menaxhon arkivin e bibliotekës;
- 1.22. Menaxhon klasifikimin dhe katalogimin e librave;
- 1.23. Udhëzon shfrytëzuesit e literaturës për mënyrën e shfrytëzimit, kohëzgjatjen e mbajtjes së librave, për çmimin etj;
- 1.24. Menaxhon personelin e bibliotekës;
- 1.25. Publikon punën e bibliotekës dhe librarisë në e-manager;
- 1.26. Kujdeset për ruajtjen dhe ngritjen e imazhit të bibliotekës dhe librarisë;
- 1.27. Përcjellë trendët e zhvillimit të fushës së bibliotekarisë;
- 1.28. Përgatit raporte periodike dhe vjetore;

### **Neni 39**

#### **Shtëpia botuese**

Organizimi dhe funksionimi i shtëpisë botuese përcaktohet me rregullore të veçantë.

### **Neni 40**

#### **Shkolla doktorale**

Organizimi dhe funksionimi i shkollës doktorale përcaktohet me rregullore të veçantë.

## **Neni 41**

### **Qendra për aftësim profesional dhe inovacion**

Organizimi dhe funksionimi i Qendrës për aftësim profesional dhe inovacion përcaktohet me rregullore të veçantë.

## **Neni 42**

### **Fakulteti**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e fakultetit janë:

- 1.1. është përgjegjës për organizimin dhe implementimin e procesit mësimor dhe hulumtues në kuadër të programeve të akredituara të studimit.
- 1.2. i propozon Senatit programe të studimit;
- 1.3. organizon mësimdhënien, provimet dhe vlerësimin e studentëve;
- 1.4. zhvillon kërkime shkencore ose krijimtari artistike sipas standardeve ndërkombëtare;
- 1.5. përdor dhe shfrytëzoj drejt dhe në mënyrë efikase mjetet e dedikuara për fakultetin;
- 1.6. siguron implementimin efikas të procedurave të sigurimit të cilësinë;
- 1.7. ofron bashkërisht programe interdisiplinare të studimeve me fakultete tjera;
- 1.8. propozon themelimin e instituteve kërkimore dhe qendrave hulumtuese;
- 1.9. nënshkruan memorandume bashkëpunimi me fakultete dhe institucione tjera të natyrës akademike.

2. Fakulteti përbëhet nga:

- 2.1. Këshilli mësimor;
- 2.2. Dekani i Fakultetit;
- 2.3. Prodekani
- 2.4. Koordinatori
- 2.5. Stafi akademik

3. Dekani i fakultetit për punën e tij i përgjigjet dhe i raporton Rektorit dhe sipas autorizimit edhe Prorektorit për çështje mësimore dhe akademike, ndërsa drejtpërdrejtë pranon detyra edhe nga Prorektorët tjerë dhe Sekretari për punët që ndërlidhen me sektorët e tyre.

4. Punëtorët tjerë të fakultetit për punën e tyre i përgjigjen Dekanit të fakultetit.

## Neni 43

### Dekani

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Dekanit janë:
  - 1.1. është përgjegjës për administrimin, planifikimin dhe koordinimin e punës në fakultet;
  - 1.2. siguron udhëheqje akademike në zhvillimin e mësimit, punës shkencore/artistike në fakultet;
  - 1.3. ndërmerr masat e nevojshme për zbatimin e vendimeve dhe të detyrave të caktuara nga senati;
  - 1.4. vlerëson nevojat për mjetet teknologjike dhe materialet mësimore për realizimin e procesit mësimorë dhe kërkimeve shkencore/artistike për rektorin dhe senatin, sipas dispozitave të statutit;
  - 1.5. bënë mbikëqyrjen dhe monitorimin e rregullt të cilësisë së prezantimeve, literaturës, metodologjisë së punës, komunikimit me studentët dhe përdorimit të platformave elektronike.
  - 1.6. përfaqëson fakultetin në senat;
  - 1.7. udhëheqë këshillin shkencor mësimorë dhe këshillin e studimeve master.
  - 1.8. përfaqëson fakultetin në aktivitetet e ndryshme, brenda dhe jashtë institucionit;
  - 1.9. koordinon dhe merr pjesë në rishikimin e plan – programit mësimor të fakultetit;
  - 1.10. krijon mundësitë profesionale dhe kushtet e punës që garantojnë avansimin dhe suksesin e studentëve dhe stafit akademik;
  - 1.11. mbikëqyrë dhe bënë vlerësimin e performancës të punës së personelit në fakultet;
  - 1.12. njofton drejtorin e degës për mungesat e profesorëve në ligjërata, provime dhe konsultime të cilët janë për degë;
  - 1.13. kujdeset për zbatimin e të gjitha kërkesave që dalin nga rregulloret për studime.
  - 1.14. monitoron zbatimin e standardeve dhe procedurave që dalin nga rregullorja për organizimin e studimeve master.
  - 1.15. përpilon dhe përcjellë respektimin e orarit të punës të personelit të fakultetit;
  - 1.16. shqyrton kërkesat dhe ankesat e personelit dhe studentëve, dhe shërben si instanca e parë e përgjigjes së tyre;
  - 1.17. inicon dhe merr pjesë në hartimin e planit zhvillimorë të fakultetit.
  - 1.18. propozon ide zhvillimore që reflektojnë specifikat e programit studimor.
  - 1.19. përgatit raportin e punës së fakultetit për çdo semestër.
  - 1.20. udhëheqë mbledhjet e rregullta me personelin mësimor.
  - 1.21. analizon performancën e studentëve në përfundim të çdo afati të provimeve.
  - 1.22. bashkëpunon me prorektorin për kërkim shkencor në organizimin e konferencave shkencore, dhe pranon detyra për mbarëvajtjen e tyre.

- 1.23. pranon rekomandime të prorektorit për kërkim shkencor në lidhje me temat master.
- 1.24. bashkëpunon me prorektorin për kërkim shkencor për projekte të ndryshme shkencore;
- 1.25. propozon zgjedhjen e personelit akademik në lëndët e fakultetit;
- 1.26. kujdeset për zbatimin e planit zhvillimor të stafit të fakultetit.
- 1.27. përgatitë raporte periodike dhe vjetore për rektorin;
- 1.28. bën vlerësimin e rregullt të stafit nën mbikëqyrje të tij dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimit për kryerje të detyrave të tyre
- 1.29. përmbushë obligime të tjera të kërkuara nga rektori.

#### **Neni 44**

#### **Prodekani**

##### 1. Detyrat dhe përgjegjësitë e prodekanit janë:

- 1.1. në bashkëpunim me dekanin e fakultetit, siguron mbarëvajtjen e punëve në njësinë akademike përkatëse të cilën e mbikëqyrë;
- 1.2. përkujdeset për administrimin, planifikimin dhe koordinimin e punës në fakultet;
- 1.3. ndërmerr masat e nevojshme për zbatimin e vendimeve dhe detyrave të caktuara nga dekanin;
- 1.4. është organi i parë që i përgjigjet kërkesave dhe ankesave të studentëve;
- 1.5. ndihmon studentët në organizimet e tyre;
- 1.6. përkujdeset dhe koordinon punën praktike të studentëve tek institucionet partnere;
- 1.7. bënë analizën e statistikave dhe përgatit raport për shkallën e suksesit të studentëve në afatet e provimeve;
- 1.8. kujdeset për evidentimin dhe përcjelljen e punës shkencore të personelit akademik.
- 1.9. me autorizimin e dekanit përfaqëson fakultetin në aktivitetet e ndryshme, brenda dhe jashtë;
- 1.10. ndihmon dekanin për hartimin e planeve dhe programeve mësimore të lëndëve që mbulon fakulteti dhe ndjek zbatimin e tyre;
- 1.11. përcjell punën dhe aktivitetet hulumtuese shkencore të stafit akademik dhe i regjistron dhe i arkivon të gjitha publikimet e stafit akademik;
- 1.12. i jep sugjerime dekanit për zgjedhjen e personelit akademik për lëndët përkatëse;
- 1.13. të udhëzojë personelin për përpilimin e orarit të punës;
- 1.14. të shqyrtojë ankesat e studentëve dhe t'i propozojë dekanit ngritjen e komisionit të provimeve akademike në lëndët që mbulon fakulteti;
- 1.15. ndihmon dekanin në hartimin e analizave të kohëpaskohshme të punës së bërë në fakultet;
- 1.16. zëvendëson dekanin në rastet kur ai gjendet me punë jashtë aab-së;
- 1.17. të përmbushë edhe obligime të tjera të kërkuara nga dekanin.

## **Neni 45**

### **Koordinatori**

#### 1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Koordinatorit janë:

- 1.1. punon duke u këshilluar ngushtë me dekanin dhe prodekanin e fakultetit;
- 1.2. koordinon punën për sigurimin e cilësisë brenda fakultetit;
- 1.3. ofron shërbime dhe ndihmesë për zbatimin e praktikave dhe nismave më të mira;
- 1.4. këshillon në aprovimin dhe zhvillimin e moduleve dhe programeve studimore;
- 1.5. përkrah zbatimin për strategjitë e përmirësimit të cilësisë;
- 1.6. përgatit feed-back-un e përmbushjes së rekomandimeve për fakultetin përkatës, nga procesi i vlerësimit, të shkruar në formë të planit të përmirësimit dhe të njëjtin e diskuton dhe rregullon në bashkëpunim me zyrën për sigurimin e cilësisë;
- 1.7. identifikon projektet dhe donacionet e jashtme për projekte të cilat janë kompatible me interesat dhe kapacitetet e fakultetit;
- 1.8. njoftimet ne web;
- 1.9. identifikimi i partnerëve;
- 1.10. propozimi i marrëveshjeve;
- 1.11. koordinimi i punës praktike të studentëve;
- 1.12. përcjellja e punës praktike;
- 1.13. mbrëmje kulturore;
- 1.14. shënimi i datave të rëndësishme për personalitetet dhe fushën e studimeve;
- 1.15. organizimi i ditëve të aktiviteteve të caktuara në fushën përkatëse (dita e drejtave të njeriut, dita e leximit, dita e fëmijës, dita e pavarësisë, ...)
- 1.16. organizimi i forumeve dhe debateve me studentë e mësime të mësuara;
- 1.17. organizimi i klubeve të studentëve;
- 1.18. ditët e prezantimit të punimeve studentore;
- 1.19. përfshirja e studentëve alumni në aktivitete të ndryshme studentore;
- 1.20. nxjerr statistika dhe përpilon raporte sipas nevojave të dekanit të fakultetit;

## **Neni 46**

### **Profesori**

#### 1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Profesorit janë:

- 1.1. në punën e vet udhëhiqet nga standardet e etikës profesionale, akademike e shkencore dhe nga parimet e respektit dhe mosdiskriminimit për studentët, kolegët dhe personat e tjerë të përfshirë;

- 1.2. përgatitë silabusin e lëndës, përfshirë ligjëratat, materialet për lexim, ushtrimet, aktivitetet dhe prezantimet, sipas formatit të përcaktuar nga zyra e cilësisë dhe e dorëzon atë në dekanat para fillimit të ligjëratave;
- 1.3. organizon ligjëratat dhe ushtrimet sipas metodave bashkëkohore të mësimdhënies;
- 1.4. propozon literaturën për lëndën e vet dhe publikon të gjitha ligjëratat dhe materialet e nevojshme në e-service;
- 1.5. mban konsultime të drejtpërdrejta me studentë ose përmes platformës e-profesor së paku 2 orë në javë;
- 1.6. organizon të gjitha format e vlerësimit të studentëve (provimet, testet, kolokiumet, seminarët etj.) në përputhje me silabusin e lëndës;
- 1.7. në bashkëpunim me asistentin e lëndës hartojnë planin e ushtrimeve për lëndën përkatëse;
- 1.8. cakton orarin, mbikëqyrë, jep informata kthyese, dhe vlerëson studentët në përvojat e punës praktike, vizita të institucioneve, matje, hulumtime, vëzhgime në terren e të tjera në përputhje me programin e lëndës.
- 1.9. organizon konsultime dhe një sistem komunikimi me studentët. harton dhe publikon orarin, mënyrën dhe mediumet e komunikimit me studentë dhe me kolegët. orari publikohet në silabusin e kursit dhe në sistemin e eprofesorit në fillim të secilit semester. për çfarëdo shmangie të kohës, vendit ose mediumit të komunikimit nga ky orar duhet të informohet dekani dhe studentët me kohë;
- 1.10. merr pjesë aktive në procesit e vlerësimit të personelit mësimdhënës qoftë nga studentët, nga zyra e cilësisë ose nga dekani;
- 1.11. merr pjesë në trajnime profesionale të cilat organizohen brenda dhe jashtë institucionit ose përcjellë trendët në fushën e vet të specializimit, të teknologjisë ose të pedagogjisë me qëllim të avancimit të performancës së studentëve;
- 1.12. merr pjesë në planifikimin, përgatitjen dhe realizimin e projekteve në fushën e arsimit të lartë dhe të kërkimeve shkencore;
- 1.13. së paku një herë në vit, publikon një artikull në revistën shkencore të institucionit “thesis kosova” ose në ndonjë revistë të njohur ndërkombëtare si mësimdhënës i AAB-së;
- 1.14. mbikëqyrë njëkohësisht deri në 10 student të studimeve master në vit nëse i plotëson kushtet sipas rregullores për studimet master;
- 1.15. merr pjesë në mbledhjet e këshillit akademik, mbledhjet e departamentit, në panele intervistuese dhe në konsultimet me profesorët sipas nevojave që paraqiten;
- 1.16. pas përfundimit të kontratës, obligohet që provimet t’i mbajë edhe për një vit akademik;
- 1.17. mban evidencë të rregullt të orëve dhe ligjëratave të mbajtura në përputhje me silabusin e lëndës;
- 1.18. përcjell trendët më të avancuara në fushën e vet të studimeve, mësimdhënie dhe shkencë;
- 1.19. u përmbahet rregulloreve në fuqi të institucionit;
- 1.20. për punën e vet i përgjigjet dekanit të fakultetit.

## **Neni 47**

### **Asistenti**

#### 1. Detyrat dhe përgjegjësitë e asistentit janë:

- 1.1. Përgatit dhe organizon ushtrimet me studentët për lëndën në të cilën është i zgjedhur;
- 1.2. Ndihmon profesorin në përgatitjen e silabusit për pjesën praktike të lëndës;
- 1.3. Në punën e vet udhëhiqet nga standardet më të larta të etikës profesionale, akademike e shkencore dhe nga parimet e respektit dhe mos diskriminimit për studentët, kolegët dhe personat e tjerë të përfshirë;
- 1.4. Në konsultim me profesorin, ofron materialet mësimore të nevojshme për studentë;
- 1.5. Mban konsultime dhe kontakte të rregullta me studentë dhe i këshillon dhe ndihmon ata sipas nevojave që paraqiten;
- 1.6. Ndihmon profesorin në organizimin e vlerësimit sumativ të studentëve;
- 1.7. Kryen të gjitha format e vlerësimit të studentëve për pjesën praktike të lëndës (provimet, testet, kolokiumet, seminarët etj.)
- 1.8. Merr pjesë në trajnime për avancim profesional të cilat organizohen nga institucioni;
- 1.9. Angazhohet në aktivitete plotësuese mësimore me studentët (trajnime, mbikëqyrje të praktikave, aktivitete të klubeve të studentëve, etj.);
- 1.10. Merr pjesë në planifikimin, përgatitjen dhe realizimin e projekteve në fushën e arsimit të lartë dhe të kërkimeve shkencore;
- 1.11. Publikon në revistën shkencore të institucionit “Thesis Kosova” ose në ndonjë revistë tjetër ndërkombëtare si mësimdhënës i AAB-së;
- 1.12. Merr pjesë në mbledhjet e këshillit mësimor shkencor, mbledhjet e departamentit dhe në konsultimet me profesorët sipas nevojave që paraqiten;
- 1.13. Mban evidencë për orët dhe ligjëratat e mbajtura në përputhje me silabusin e lëndës;
- 1.14. Përcjell trendët më të avancuara në fushën e vet të studimeve, mësimdhënie dhe shkencë;
- 1.15. U përmbahet dispozitave të rregulloreve në fuqi të institucionit.

## **Neni 48**

### **Zgjidhja e konfliktit të kompetencave**

Çdo konflikt kompetence që paraqitet gjatë ushtrimit të detyrave nga punonjësit, do të paraqitet tek Rektori dhe në koordinim me menaxherët përkatës, do të zgjidh konfliktin duke përcaktuar qartë përgjegjësinë e secilit punonjës.

## **Neni 49**

### **Dispozitat kalimtare**

Kjo rregullore përcakton detyrat dhe përgjegjësit e secilit zyrtar dhe secili obligohet t'i përmbahet hierarkisë së përcaktuar nga kjo rregullore.

## **Neni 50**

1. Sipas detyrave dhe përgjegjësi të parapara me këtë rregullore, zyrtarët përgjegjës dhe kompetent për komunikim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), Agjencinë e Kosovës për Akreditim dhe autoritetet tjera qeveritare dhe jo qeveritare janë: Rektori, Prorektorët, Udhëheqësi i zyrës për sigurim të cilësisë dhe Sekretari i përgjithshëm.
2. Në raste të veçanta Rektori mund të autorizoj edhe zyrtarë tjerë për komunikim me institucione të ndryshme varësisht prej llojit të punëve.

## **Neni 51**

Secili mbikëqyrës obligohet sipas kësaj rregulloreje dhe Rregullores për vlerësimin e performancës që njëherë në vit të bëjë vlerësimin e performancës së zyrtarëve të tij dhe vlerësimet t'i dorëzojë në Zyrën për personel.

## **Neni 52**

1. Një zyrtar mund të ushtrojë më shumë se një pozitë, në këtë rast si pozitë e parë përcaktohet pozita më e lartë për nga hierarkia dhe për këtë pozitë kompensohet 100% të pagës të paraparë për atë pozitë, ndërsa për pozitën e dytë kompensohet 50% të pagës të paraparë për atë pozitë.
2. Nëse zyrtari është i caktuar më shumë se në dy pozita, atëherë për pozitën e tretë e tutje nuk ka të drejtë për kompensim.

## **Neni 53**

Kjo Rregullore mund të ndryshohet sipas procedurës së njëjtë të miratimit të saj.

## **Neni 54**

Në rast të paqartësive në zbatimin e kësaj rregulloreje, të drejtën e interpretimit e ka Rektori dhe Sekretari i përgjithshëm.



### Neni 55

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues dhe nënshkrimin nga Kryetari i Këshillit Drejtues.

### Neni 56

Pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje janë Organogrami, Tabela e koeficientit dhe Katalogu i përshkrimit të vendeve të punës.

### Neni 57

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregullorja për Organizimin dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës Ref.nr. 339/2019 e datës 25.06.2019.

Prishtinë 2024

Ilir Tafa, Kryetari i Këshillit Drejtues





# Kolegji AAB

Rr. "Elez Berisha", nr. 56, Zona Industriale  
Prishtinë-Fushë Kosovë, 10000 Prishtinë,  
Republika e Kosovës,  
Tel: +383 38 600 005; +383 45 284 797  
Mail: [info@aab-edu.net](mailto:info@aab-edu.net);  
[www.aab-edu.net](http://www.aab-edu.net)

Ref. nr. 215124 Prishtinë, 29/04/2024

Këshilli Drejtues, në mbledhjen e mbajtur më datën 29/04/2024 mori këtë:


## V E N D I M



1. MIRATOHET Rregullorja për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës

Vendimi t'u dorëzohet:

1. Prorektorëve
2. Sekretarit
3. Dekanëve


Ilir Tafa, Kryetar i Këshillit Drejtues





*Handwritten signature in blue ink.*

Fakultetet	Biblioteka universitare	Shtëpia Botuese	Shkolla doktorale	Zyra për sigurim të cilësise	Zyra për bashkëpunim të jashtëm	Zyra për teknologji
Dekani i fakultetit Prodekan Koordinatori	Drejtori i bibliotekës Zyrtare në bibliotekë Zyrtare në libran	Këshilli botues Drejtori i shtëpisë botuese Zyrtar administrativ	Këshilli i shkolles doktorale Drejtori i shkolles doktorale Zyrtar administrativ	Udhëheqësi i zyrës për sigurim të cilësise Zyrtar për sigurim të cilësise	Udhëheqës i zyrës për bashkëpunim të jashtëm Zyrtar për bashkëpunim Zyrtar për aktivitete Zyrtar për mobilitet	Drejtori i zyrës për teknologji Përgjegjës i njësive të zhvillimit të softuerit Zhvillues i softuerit Përgjegjës i njësive të infrastrukturës dhe komunikimit Specialist i rjetave Teknik i harduerit Përgjegjës i njësive për sigurim kibernetike Teknik i sigurisë kibernetike
Zyra qendrore për studente	Zyra për marketing	Zyra e financave	Zyra e shërbimeve mbështetëse		Zyra për marrëdhënie me publikun	
Drejtor i zyrës qendrore për studente Zyrtar/e Administrative Zyrtar për transfer të studentëve Asistent administrativ në shërbimin e informatave	Drejtori i marketingut Përgjegjës për sektore Zyrtar për marketing Agjent i marketingut	Drejtor i zyrës për financa Zyrtar i financave Kontabilist Arkëtar Koordinator për rikthim të studentëve Zyrtar për rikthim të studentëve	Menaxher i shërbimeve mbështetëse Punëtor në shërbimin teknik Vozitës Punëtor i sigurimit Punëtor i higjenes	Menaxher i furnizimit Zyrtar për furnizim Zyrtar për regjistrim të inventarit	Drejtor i ZMP-së Gazetar/Redaktor Administratori i ueb-it Dizajner grafik Realizator Kameraman Fotograf Zyrtar për protokoll Lektor Digital and social media specialist	Teatri "Ferah Begolli" Teatra "Kameral" Radio AAB KNN
Zyra për projekte	Zyra për personel	Zyra për diploma	Zyra për karrierë	QAPI		
Udhëheqësi i zyrës së projekteve Zyrtar për projekte Zyrtar për buxhet dhe financa	Zyrtar i personelit Zyrtar juridik	Udhëheqësi i zyrës për diploma Zyrtar për diploma Zyrtar për arkiva	Udhëheqësi i zyrës së karrieres Zyrtar për praktika të studentëve Zyrtar për karrieres Zyrtar për alumni	Drejtori i QAPI Këshilli profesional Zyrtar administrativ Bashkëpunëtorët e jashtëm		



Kategoria funksionale	Koeficienti	Titulli i vendit të punës
Nivel i lartë drejtues	K1	Rektori
Nivel i lartë drejtues	K2	Prorektori për çështje mësimore dhe akademike
Nivel i lartë drejtues	K3	Prorektor për shkencë
		Prorektor për financa
		Prorektor për planifikim dhe zhvillim
		Prorektor për bashkëpunim të jashtëm
		Sekretar i përgjithshëm
		Udhëheqës i zyrës për sigurim të cilësisë

Niveli drejtues	KA	Dekani
		Drejtori i degës
		Drejtor i zyrës për financa
		Drejtor i zyrës qendore për studentë
		Drejtor i marketingut
		Drejtor i zyrës për marrëdhënie me publikun
		Drejtor për teknologji
	K5	Drejtor i bibliotekës
		Drejtor i shkollës doktorale
		Menaxheri i shërbimeve mbështetëse
		Menaxher i furnizimit
		Drejtor i shtëpisë botuese
		Drejtor i QAPI
		Udhëheqës i zyrës për bashkëpunim të jashtëm
		Udhëheqës i zyrës për karrierë
Udhëheqës i zyrës për projekte		
Udhëheqës i zyrës për diploma		

Nivel profesional	K6	Administrator i rrjetit
		Inxhinieri i softuerit
		Administratori për teknologji
		Zyrtar për siguri kibernetike
		Administrator i ueb-it
		Dizajner grafik
		Digital and Social Media Specialist
	K7	Koordinatori i Fakultetit
		Këshilltar për media dhe marrëdhënie me publikun
		Këshilltar për analiza dhe inovacion
		Këshilltar për çështje juridike
		Shofer i Rektorit
		Zyrtar i personelit
		Zyrtar juridik
		Zyrtar për sigurim të Cilësisë
		Zyrtar për bashkëpunim
		Zyrtar për aktivitete
		Zyrtar për mobilitet
Përgjegjës për sektorë		

		Zyrtar për praktika të studentëve
		Zyrtar për karrierë
		Zyrtar për alumni
		Zyrtar për projekte
		Zyrtar për buxhet dhe financa
	K8	Realizator
		Kamerman
		Fotograf
		Zyrtari për protokol
		Lektor
		Gazetar-redaktor
		Kontabilisti
		Koordinator për rikthim të studentëve
		Vozitës
		Punëtor i sigurimit
		Asistente administrative në Zyrën e Rektorit

Nivel administrativ	K9	Zyrtar i financave
		Zyrtar për furnizim
		Arkëtari
		Zyrtar për diploma
		Zyrtar i marketingut
		Zyrtar Administrativ
		Zyrtar për transfer të studentëve
		Zyrtar për rikthim të studentëve
	K10	Zyrtar për regjistrim të inventarit
		Zyrtar për arkiva
		Zyrtar/e në bibliotekë
	K11	Zyrtar/e në librari
		Asistent administrativ në shërbimin e informatave
		Agjent i marketingut

Nivel teknik	K12	Punëtor në shërbimin teknik
		Punëtor i higjienës





Kolegji AAB

Rr. "Elez Berisha", nr. 56, Zona Industriale  
Prishtinë-Fushë Kosovë, 10000 Prishtinë,  
Republika e Kosovës,  
Tel: +383 38 600 005; +383 45 284 797  
Mail: [info@aab-edu.net](mailto:info@aab-edu.net);  
[www.aab-edu.net](http://www.aab-edu.net)

Ref. nr. 217 Prishtinë, 29/04/2024



# KATALOGU

## I PËRSHKRIMIT TË VENDEVE TË PUNËS

Prishtinë 2024

Në mbështetje të Rregullores së Kolegjit AAB për Përshkrimin dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, Zyra për personel obligohet të hartojë katalogun e vendeve të punës i cili duhet të përmbajë informatat në vijim:

1) **Përshkrimi i përgjithshëm i vendit të punës**

<b>1. Emri i institucionit:</b>	<b>Kolegji AAB</b>
<b>2. Titulli i vendit të punës:</b>	<b>Rektori</b>
<b>3. Kategoria funksionale:</b> (Nivel i lartë drejtues, nivel drejtues, nivel profesional, nivel administrativ)	Nivel i lartë drejtues
<b>4. Departamenti/zyra:</b> (në kuadër të institucionit)	Rektorati
<b>5. Divizioni/ njësia:</b> (në kuadër të departamentit)	
<b>6. Raporton tek:</b> (titulli dhe grada e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë)	Këshilli Drejtues
<b>7. Vendi i punës / kampusi:</b> (vendi ku kryhen detyrat)	Prishtinë

2) **Qëllimi i vendit të punës:** (Përshkrim i shkurtër i qëllimit të pozitës dhe çka duhet të arrihet në këtë pozitë):

Udhëheqja e institucionit në përmbushjen e misionit dhe vizionit, duke siguruar cilësi të lartë në arsim, shkencë dhe shërbime ndaj komunitetit. Rektori është përgjegjës për menaxhimin e institucionit dhe krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për të gjithë anëtarët e komunitetit akademik dhe jo akademik.

3) **Detyrat kryesore:** (përshkrim i shkurtër i detyrave kryesore, të renditura për nga rëndësia):

<b>Detyrat dhe përgjegjësitë</b>
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. të veprojë në emër të AAB-së dhe ta përfaqësojë atë para publikut dhe më gjerë;</li> <li>2. të planifikojë, organizoj, udhëheqë dhe të mbikëqyre proceset dhe zhvillimet e institucionit;</li> <li>3. t'i prezantojë Këshillit Drejtues propozimet, rekomandimet dhe opinionet e Senatit;</li> <li>4. të kryesojë Senatin;</li> <li>5. të vendosë një sistem të brendshëm për sigurimin e cilësisë;</li> <li>6. të drejtojë dhe zhvillojë gjithë punën mësimore – edukuese e shkencore – artistike;</li> <li>7. të sigurojë shfrytëzimin efikas, ekonomik dhe të dobishëm të mjeteve të AAB-së;</li> <li>8. të sigurojë përdorimin efikas të burimeve, kapaciteteve të AAB-së dhe ruajtjen e pronës;</li> <li>9. të vendosë për shpalljen e konkursit për pranimin e studentëve;</li> <li>10. i propozon Këshillit Drejtues strategjinë për bursa;</li> <li>11. të zbatojë vendimet e Këshillit Drejtues;</li> </ol>



12. t'i propozojë Këshillit Drejtues Prorektorët;
13. të emërojë personelin udhëheqës në pozita të caktuara;
14. të shpallë fituesit e konkurseve të pranimit;
15. të ndajë çmime dhe mirënjohje;
16. inicon nxjerrjen e rregulloreve të reja, plotësimin dhe ndryshimin e tyre, dhe ndryshimin e statutit;
17. të mbajë takime të rregullta javore me stafin menaxherial dhe njofton Kryetarin e Këshillit Drejtues për vendimet e marra në këto takime;
18. të nënshkruaj diplomat e të diplomuarve të të gjitha niveleve;
19. formon komisione ad hoc për çështje të caktuara;
20. bën vlerësimin e rregullt të stafit nën mbikëqyrje të tij dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimit për kryerje të detyrave të tyre
21. të kryejë të gjitha detyrat e tjera siç janë përcaktuar me këtë Statut dhe rregulloret e tjera në fuqi.

4) **Shkathtësitë e kërkuara** (kualifikimet, përvojat si dhe aftësitë dhe shkathtësitë e tjera që kërkohen për këtë vend të punës):

**4.1) Përgatitja profesionale dhe kualifikimet:**

1. Të ketë përvojë të dëshmuar në mësimdhënie akademike dhe kërkime shkencore;
2. Të ketë arritur gradën e Doktorit të Shkencave;
3. Të ketë thirrje akademike;
4. Të njohë shkëlqyeshëm gjuhën angleze (shkrim dhe lexim);
5. Preferohet njohja edhe të një gjuhe tjetër;
6. Përvojë pune në pozita menaxhuese minimum dhjetë vite;

**4.2) Aftësitë kryesore, njohuritë, shkathtësitë e kërkuara** (ju lutem i specifikoni esencialet ose të dëshirueshmet)

1. Të ketë aftësi të dëshmuara menaxhuese;
2. Të ketë kualitete të larta morale;
3. Aftësi të mira komunikimi;
4. Njohuri të shkëlqyeshme të punës me kompjuter (aplikacionet e MS Office);
5. Aftësi të mira të punës në ekip dhe punë nën presion;

Në mbështetje të Rregullores së Kolegjit AAB për Përshkrimin dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, Zyra për personel obligohet të hartojë katalogun e vendeve të punës i cili duhet të përmbajë informatat në vijim:

1) **Përshkrimi i përgjithshëm i vendit të punës**

<b>1. Emri i institucionit:</b>	<b>Kolegji AAB</b>
<b>2. Titulli i vendit të punës:</b>	<b>Prorektori për çështje mësimore dhe akademike</b>
<b>3. Kategoria funksionale:</b> (Nivel i lartë drejtues, nivel drejtues, nivel profesional, nivel administrativ)	Nivel i lartë drejtues
<b>4. Departamenti/zyra:</b> (në kuadër të institucionit)	Rektorati
<b>5. Divizioni/ njësia:</b> (në kuadër të departamentit)	
<b>6. Raporton tek:</b> (titulli dhe grada e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë)	Rektori
<b>7. Vendi i punës / kampusi:</b> (vendi ku kryhen detyrat)	Prishtinë

2) **Qëllimi i vendit të punës:** (Përshkrim i shkurtër i qëllimit të pozitës dhe çka duhet të arrihet në këtë pozitë):

